



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2026

VENDIM

Nr. 215, datë 22.04.2026

PËR

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT ADRIATIK BOCAJ,
ME QËLLIM GRADIMI, PËR PERIU DHËN E VLERËSIMIT 2013-2016**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit Adriatik Bocaj, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relatore znj. Irena Plaku,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtarit Adriatik Bocaj, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

- A. Aftësitë profesionale – “Mirë”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
- Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Mirë”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

**ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E
VLERËSIMIT
DHE PËRCAKTIMI I NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER
VLERËSIMI**

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit Adriatik Bocaj në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsyetimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekte, njohuritë ligjore dhe arsyetimi ligjor, të cilët ndahen në disa nëntregues.

1.A. NJOHURITË LIGJORE

1.A.A. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e së tërës përkethehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, të cilët do të përcaktojnë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë, edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e saj. Në vijim, analizohet mënyra se si janë evidentuar këta elementë ligjorë në vendimet burim vlerësimi për gjyqtarin Adriatik Bocaj.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë :

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se : “*Subjekti i rivlerësimit, gjyqtari Adriatik Bocaj, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Ai njeh parimet e përgjithshme të së drejtës e të procesit të rregullt ligjor dhe i zbaton ato në praktikë, por nuk përdor referenca nga jurisprudence unifikuese e Gjykatës së Lartë (shih dosjet 1, 2, 3 e 4).*

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se përgjithësisht identifikon normën materiale të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në çështjet civile të analizuara është konstatuar se vendimi gjyqësor përmban referenca ligjore, duke dhënë dhe arsyet e zgjidhjes së çështjes (shih dokumentet 1 e 2 dhe dosjet 1, 2, 3 e 4). Në çështjet administrative penale, i kushton rëndësi zbatimit të kriterëve ligjore për arrestimin në flagrancë dhe atyre për caktimin e masave të sigurimit (shih dokumentin 3 dhe dosjen 5).

Ka njohuri të mira të procedurave të gjykimit, në raport me llojin e çështjeve gjyqësore civile apo penale që ka shqyrtuar. Njeh aspektet e procesit të rregullt ligjor në drejtim të pjesëmarrjes së palëve në gjykim, të kontradiktoritetit e gjer tek arsyetimi i vendimit gjyqësor. Ndër 3 dokumentet e përzgjedhura dhe 5 dosjet e vëzhguara, janë ankimuar 3 prej tyre. Në të tre rastet, gjykata e apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit (shih dokumentet 1 e 2 dhe dosjen 1) ndërsa në 4 raste nuk është ushtruar ankim nga palët (shih dosjet 2, 3, 4 e 5). Për një nga dokumentet nuk pasqyrohen të dhëna lidhur me ushtrimin ose jo të ankimit ndaj këtij vendimi (shih dokumentin 3)”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

- Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes :

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se pas përshkrimit të kërkesë/ padisë me anë të cilës pala paditëse/kërkuese i është drejtuar gjykatës, përgjithësisht gjyqtari e fillon arsyetimin e vendimit me përshkrimin e fakteve të çështjes, të cilat kanë rezultuar të provuara nga provat shkresore dhe ato me dëshmitarë të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Faktet e çështjes në përgjithësisht janë paraqitur në mënyrë kronologjike, duke integruar në disa raste në përmbajtje të tyre, edhe provat e administruara mbi bazën e të cilave nga gjykata është vlerësuar se provohet fakti konkret, si dhe duke cituar në disa raste edhe pjesë të përmbajtjes së provave shkresore apo në raste të veçanta edhe të provave të tjera, sikurse është ekspertimi/raporti psikologjik kur është marrë një provë e tillë.

Pretendimet dhe provat e paraqitura nga palët përgjithësisht parashtrohen duke i gërshetuar në raport me faktet e çështjes, të cilat gjithashtu në disa raste janë përshkruar sipas pretendimeve të palës paditëse (kryesisht përmbajtjes së kërkesë padisë apo parashtimeve të palës paditëse me shkrim) Evidentohet në përgjithësi një analizë (jo e detajuar) e të gjitha provave të marra në gjykim në funksion të konkluzionit në lidhje me marrëdhënien juridike civile ndërmjet palëve, në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Ndërsa në disa vendime, konstatohet se rrethanat e faktit mbi bazën e të cilës gjyqtari ka marrë vendimin nuk janë përshkruar dhe analizuar në mënyrë të plotë nga gjyqtari. Ai mjaftohen me përshkrimin disa fakteve dhe për disa të tjera jep vetëm konkluzionet, se faktet janë provuar në gjykim, pa përshkruar provat e administruara mbi bazën e të cilave nga gjykata është vlerësuar se provohet fakti konkret¹. Në disa raste faktet e çështjes janë përshkruar sipas pretendimeve të paraqitura nga pala paditëse në kërkesë padi, por edhe në këtë rast nuk paraqiten në mënyrë të plotë². Ndërsa tek një vendim me objekt zgjidhjen martesë³, konstatohet se faktet e çështjes si dhe konkluzionet e gjykatës nuk paraqiten në mënyrë të qartë. Fillimisht gjyqtari përshkruar faktin se palët janë të martuar dhe nga martesa kanë lindur fëmijë, pastaj vijon me përshkrimin e fakteve sipas pretendimeve të palëve, lidhur me konfliktet që ata kanë pasur midis njëri-tjetrit dhe më pas në referim të nenit 132 të K.Familjes, gjyqtari del në konkluzionit se martesa duhet të zgjidhet, pasi jetesa e përbashkët është bërë e pamundur dhe në vijim pas referimit të përmbajtjes së nenit, konstatohet se gjyqtari përshkruan konkluzionet e ekspertës, por pa i identifikuar ato si të tilla. Në vijim, gjyqtari shprehet se “më zgjidhjen e martesës fëmijët i janë lënë për rritje dhe edukim paditëses jo vetëm se paditësia është dakord, por edhe në respektim të nenit 157 të Kodit të Familjes, gjykata ka marrë në konsideratë edhe mendimin e specializuar të psikologes e cila

¹ Vendimi 1951, datë 11.02.2014, nr.3581, datë 18.03.2014, nr.7756, datë 15.10.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

² Vendimi nr.5785, datë 10.07.2015, nr.6862, datë 08.09.2016

³ Vendimi nr.5408, datë 02.05.2014

ka rekomanduar”, duke vijuar më pas me përshkrimin e rekomandimeve të dhënë nga psikologjia.

Rezulton se gjyqtari në disa raste (në disa vendime) përshkruan procedurën e ndjekur gjatë gjykimit dhe merr në shqyrtim (jo gjithmonë) juridiksionin dhe kompetencën e shqyrtimit të saj. Në ato raste kur gjatë gjykimit ka marrë vendime të ndërmjetme, gjyqtari e parashtron këtë fakt, menjëherë pas prezantimit të padisë (*zhvillimin e gjykimit në mungesë të palës së paditur, veçimin e kërkimeve duke vijuar gjykimin për njërin nga palët paditëse etj.*).

Në dy çështjet penale/kërkesë penale me objekt “Vleftësim të ligjshëm ndalimi/arrestimi dhe caktim mase sigurimi personal”⁴, faktet gjenden të pasqyruara në mënyrë kronologjike në një pjesë të evidentueshme të pjesës përshkruese-arsyetuese, pas të cilave gjyqtari parashtron vlerësimet për shkaqet e posaçme dhe të dhënat që përlligjin pranimin e kërkesës për vleftësimin e ligjshëm të ndalimit apo arrestimit, si dhe lidhur me masën e shtrënguese të sigurimit, të kërkuar nga organi i akuzës, duke mbërritur në përfundimin se i përshtatet kriterëve të parashikuara në nenet 228, 229, 230, 238 të K.Pr.Penale.

- **Identifikimi i natyrës së çështjes**

Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i faktit juridik, gjykata krijon idenë e saj rreth natyrës së marrëdhënies juridike për shkak të së cilës çështja i është paraqitur gjykatës për shqyrtim, ku në rastin konkret, të gjitha vendimet burim vlerësimi i përkasin natyrës juridike civile dhe familjare, përveç dy çështjeve penale/kërkesa penale, të iniciuar nga organi i akuzës, me objekt “Vleftësim të ligjshëm ndalimi/arrestimi dhe caktim mase sigurimi personal”⁵. Pas përcaktimit të natyrës së marrëdhënies juridike, gjyqtari përgjithësisht përcakton drejt edhe institutin juridik përkatës në çështjet civile (*nëse jemi para një marrëdhënie familjare, një marrëdhënie detyrimi, etj.*), por nuk konstatohet se gjyqtari bën një përcaktim të qartë të natyrës së kërkesës penale të paraqitur, duke mos bërë një dallim të qartë mes kërkesës për vleftësim arresti dhe kërkesës për vleftësim ndalimi.

Rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarit i jepet përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve kryesisht në çështjes civile dhe familjare, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të saj. Vihet re se gjyqtari jo gjithmonë merr në analizë në mënyrë të shprehur juridiksionin dhe kompetencën e gjykatës (*lëndore dhe tokësore*) për shqyrtimin e çështjes, përse kohë që nuk ka pasur asnjë kërkesë nga palët. Nga vlerësimi i vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtari dhe atyre të përzgjedhura me short, vihet re që natyra juridike e çështjes nuk është identifikuar gjithmonë në mënyrë specifike, por përgjithësisht del qartë referuar identifikimit të elementeve dhe kriterëve ligjore të mosmarrëveshjes juridike në çdo vendim gjyqësor

⁴ Vendimet nr. 2510 akti, datë 08.10.2016; nr. 2634 akti, datë 20.10.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁵ Vendimet nr. 2510 akti, datë 08.10.2016; nr. 2634 akti, datë 20.10.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

civile burim vlerësimi. Siç u theksua më lartë, tek kërkesat penale natyra juridike e tyre nuk del e qartë.

- *Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm material dhe procedural*

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes, nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështjes, por gjithashtu lidhet me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Referuar burimeve të vlerësimit, në këtë aspekt, evidentohet se gjyqtari përgjithësisht identifikon dhe citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në mos citimin apo listimin e dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk të referojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi.

Duke i ndarë vendimet gjyqësore, objekt vlerësimi në dy kategori :

- (i) vendime gjyqësore civile
- (ii) vendime gjyqësore penale,

në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, por edhe atij procedural të evidentuar për zgjidhjen e kërkesave apo situatave procedurale, konstatohet se:

(i) *Në vendimet gjyqësore civile*, gjyqtari identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar jo vetëm dispozitave materiale të Kodit Civil, Kodit të Familjes, por edhe ligjeve organike përkatëse, nga ku evidentohet më konkretisht :

- Në vendimet gjyqësore, me objekt “Lëshim urdhër i menjëhershëm mbrojtje” gjyqtari identifikon si ligj të zbatueshëm, ligjin nr. 9669, datë 18.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, dduke u shprehur se gjykata në lëshimin e urdhërit të mbrojtjes duhet të mbështetet në nenin 10 të ligjit⁶, citon përmbajtjen e nenit 15 të ligjit, lidhur provat që mund të merren në shqyrtim si dhe faktin se në rast se nuk ka prova gjyqtari e bazon vendimin vetëm në përshkrimin e rrethanave të fakteve, duke u bazuar në bindjen e vet⁷. Në mbështetje të kësaj analize gjyqtari referon dhe citon dispozita nga ligji nr. 104/2012 për ratifikimin e Konventës të Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, konkretisht nenet 3, 4, 12⁸.

- Në vendimet gjyqësore, me objekt “Zgjidhje martesë dhe rregullimin e pasojave që vijnë prej saj” gjyqtari identifikon si ligj të zbatueshëm Kodin e Familjes, në funksion të analizimit të fushës së zbatimit të këtij kodi, përkufizimit të marrëdhënies martesore dhe detyrimet që vijnë prej saj, shkeljes së detyrimeve që vijnë nga martesë jetesë e përbashkët, parimin e interesit më të lartë të fëmijës së mitur, të drejtat dhe detyrimet e prindërve në lidhje me fëmijën e mitur, marrjen në konsideratë të mendimit të specializuar të ekspertit psikolog, kthimin ose jo të mbiemrit të vajzërisë, të drejtën e gjykatës për shtyrjen e shpalljes së vendimit deri në një vit kur nuk ka krijuar bindje se përjashtohet çdo mundësi pajtimi e

⁶ Vendimi nr. 1951, datë 11.02.2014

⁷ Vendimi nr. 1411, datë 25.02.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁸ Vendimi nr. 1411, datë 25.02.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

bashkëshortëve, të drejtën për t'u shprehur në lidhje me fajësinë vetëm kur kjo kërkohet prej palëve, etj. (konkretisht nenet 1, 6, 55, 132, 133, 136, 143, 146, 155, 157, 158, 161)⁹. Për përcaktimin e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, gjyqtari referon dhe citon dispozita nga ligji nr. 104/2012 “Për ratifikimin e Konventës të Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, konkretisht nenin 31, pika 1 (që gabmishit është shënuar pika 173) , por duke mos e cituar të saktë përmbajtjen e kësaj dispozite, megjithëse është shënuar në thonjëza¹⁰.

- Në vendimin gjyqësor, me objekt “Lëshim autorizimi për tjetërsim pasurie në emër të të miturit”, gjyqtari identifikon si ligj të zbatueshëm Kodin e Familjes, konkretisht nenin 234 të këtij kodi, lidhur me autorizimin që kërkohet nga gjykata për të kryer veprime që kapërcejnë kufijtë e administrit të thjeshtë të pasurisë së të miturit¹¹.

- Në vendimet gjyqësore, me objekt “Detyrim për kthim shume të papaguar nga shërbimi telefoni fiks”, gjyqtari identifikon si ligj të zbatueshëm nenet 419, 445, 690, 698 të Kodit Civil, për të analizuar se kontrata e lidhur me vullnetin e lirë sjell të drejta dhe detyrime reciproke dhe se shkelja e këtyre detyrimeve nga njëra palë, i jep të drejtë palës tjetër që në mënyrë alternative të kërkojë zgjidhjen e kontratës ose përmbushjen e detyrimit që buron prej saj, për të konkluduar më pas së detyrimi që buron nga kontrata nuk është përmbushur¹². Gjithashtu, gjyqtari referon 419 dhe 698 të Kodit Civil për të mbështetur konkluzionin se pala e paditur nuk ka likujduar faturat telefonike për shërbimin e ofruar atij nga pala paditëse¹³.

- Në vendimin me objekti pagim detyrimi, gjyqtari identifikon si ligj të zbatueshëm nenet 419, 420, 447, për të mbështetur konkluzionin se i padituri detyrohet të shlyejë paditësit detyrimin si pasojë e furnizimit të tij, detyrim të cilën nuk e ka shlyer si dhe lidhur me faktin se paditësi e ka njoftuar për të përmbushur detyrimin në llogarinë bankare, në monedhë në lek dhe se i padituri nuk e ka shlyer¹⁴;

- Në vendimin gjyqësor, me objekt “Detyrimin për të ndaluar publikimet dhe heqjen e materialeve të publikuara në të gjitha formatet të cilat janë cenuese të jetës private” gjyqtari ka identifikuar si ligj të zbatueshëm nenet 625 të Kodit Civil (duke cituar vetëm numrin dhe jo përmbajtjen e nenit), citim i cili është bërë sipas përshkrimit të bërë nga pala paditëse në pretendimet e paraqitur nga ana e saj, për të mbështetur konkluzionin se përfundimtar se pala e paditur duhet të detyrohet të ndalojë publikimet në të gjitha format, pasi ato janë cenuese të jetës private të palës paditëse¹⁵. Në lidhje me të drejtën e privatësisë dhe jetës së qetë

⁹ Vendimet nr. 10036, datë 20.10.2014; nr. 1533, datë 02.03.2015; nr. 5408, datë 02.05.2014; nr. 4919, datë 17.04.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹⁰ Vendimi nr. 10036, datë 20.10.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹¹ Vendimi nr. 3581, datë 18.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹² Vendimet nr. 3004, datë 12.04.2016; nr. 2092, datë 15.03.2016; nr. 5785, datë 10.07.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹³ Vendimi nr. 5785, datë 10.07.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹⁴ Vendimin nr. 6862, datë 08.09.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁵ Vendimi nr. 7756, datë 15.10.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

private e familjare e cila mbrohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (citon nenet 35, 36, 53), si dhe nenin 8 nga Konventa Europiane e Drejtave të Njeriut, por edhe ky citim është bërë sipas përshkrimit të bërë nga pala paditëse (pra gjyqtari në këtë rast ka përshkruar rrethanat dhe faktet, ligjin e zbatueshëm dhe analizën juridike, duke cituar pretendimet e bërë nga pala paditëse, sipas përshkrimit të bërë nga kjo palë në parashtrimet e paraqitura prej saj me shkrim, dhe në përfundim është shprehur për pranimin e padisë, pa identifikuar vetë ligjin e zbatueshëm si dhe pa bërë një interpretim dhe analizë të tyre për të mbështetur konkluzionin e arritur).

Në vendimet gjyqësore civile, evidentohet citimi i dispozitave procedurale civile të cilat kanë lidhje, si me zgjidhjen përfundimtare të çështjes, ashtu edhe në funksion të zgjidhjes së çështjeve dhe kërkesave procedurale. Konkretisht identifikohen :

- Neni 36 i K.Pr.Civile lidhur me juridiksionit gjyqësor të cilën gjykata ka për detyrë fillimisht ta shqyrtojë nëse mosmarrëveshja hyn në në juridksionin gjyqësor dhe më pas të vlerësojë nëse ajo është kompetente për shqyrtimin e saj, në respektim të parimit të një procesi të rregullt ligjor, duke cituar nenet 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe 42 të Kushtetutës. Gjithashtu, gjyqtari referon edhe vendimin nr. 11, datë 08.01.2013 të Gjykatës së Lartë¹⁶ ;
- Nenet 41, 51 të K.Pr.Civile në lidhje me kompetencën lëndore dhe tokësore të gjykatës në shqyrtimin e çështjes, duke vijuar me nenin 359 të K.Pr.Civile ¹⁷referuar objektit të padisë që e bën kompetente gjykatën për shqyrtimin. Në funksion të analizës së kompetencës së gjykatës, gjyqtari referon dispozita nga ligji nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe vendimin nr. 13, datë 08.01.2013 të Gjykatës së Lartë¹⁸;
- Neni 43 i K.Pr.Civile lidhur me kompetencën tokësore, në rastin kur pala e paditur është person juridik dhe për rrjedhojë padia ngrihet në gjykatën e vendit ku ka qendrën kjo palë¹⁹;
- Nenet 31, 32/a të K.Pr.Civile në lidhje me legjitimitimin e palës për ngritjen e padisë, në bazë të së cilës do të përfitojë të drejtat pasurore juridiko civile²⁰;
- Nenet 71, 72, 73 të K.Pr.Civile mbi verifikimin e ekzistencës ose jo të shkaqeve të papajtueshmërisë ose përjashtimit nga gjykimi, duke konkluduar edhe si një fakt i pakundërshtuar nga palët në gjykim²¹;
- Neni 35 i K.Pr.Civile në lidhje me gjykimin e çështjes si gjyqtar i vetëm²²;

¹⁶ Vendimi nr. 1533, datë 02.03.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹⁷ Neni 359 i K.Pr.Civile është shfuqizuar me ligjin nr.9062, datë 8.5.2003

¹⁸ Po aty

¹⁹ Vendimi nr. 2092, datë 15.03.2016; nr. 7756, datë 15.10.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

²⁰ Vendimet nr. 5785, datë 10.07.2015; nr. 2092, datë 15.03.2016; nr. 7756, datë 15.10.2015 të Gjykatës së Rrethit

Gjyqësor Tiranë.

²¹ Vendimet nr. 5785, datë 10.07.2015; nr. 7756, datë 15.10.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

²² Vendimet nr. 5785, datë 10.07.2015; nr. 2092, datë 15.03.2016; nr. 7756, datë 15.10.2015 të Gjykatës së Rrethit

Gjyqësor Tiranë.

- Neni 179 i K.Pr.Civile në lidhje me zhvillimin e gjykimit në mungesë të palëve, në kushtet e dijenisë së rregullt të tyre²³; neni 133 i K.Pr.Civile në lidhje me njoftimin e palës me anë të publikimit të shpalljes kur rezulton e pamundur njoftimi në adresë të saktë ;
- Neni 6 i K.Pr.Civile në lidhje me përcaktimin se gjykata nuk mund të dalë tej kërkimeve të parashtruara nga pala në padi²⁴;
- Nenet 510, 511 të K.Pr.Civile në rastet e lëshimit të urdhërit të ekzekutimit bashkëngjitur vendimit përfundimtar i cili përmban një detyrim dhe përbën titull ekzekutiv i cili vihet në lëvizje nëpërmjet lëshimit të urdhërit të ekzekutimi, si dhe nenin 310 të K.Pr.Civile i cili dikton gjykatën në lidhje me vendimet e saj, për të cilat duhet të lëshojë urdhër ekzekutimi të shoqërojnë në çdo rast me kopje urdhri²⁵ ;
- Nenet 158, 158/a/1 të K.Pr.Civile, lidhur me veprimet përgatitore dhe zhvillimin e seancës apo marrjen e vendimeve për kalimin e çështjeve për shqyrtim në seancë gjyqësore²⁶ ;
- Neni 172 të K.Pr.Civile mbi hapin procedural të deklarimit të hapur të shqyrtimit gjyqësor duke i dhënë fjalën palës paditëse për të dhënë shpjegime rreth padisë dhe për të paraqitur prova në dobi të gjykimit ; në nenet 183/2, 213 të K.Pr.Civile mbi lejimin për marrjen e provave të paraqitura nga pala dhe fillimin e hetimit gjyqësor me shqyrtimin e tyre duke ftuar palët nëse kanë komente për to; nenet 20, 29, 125, 183 të K.Pr.Civile mbi administrimin e provave shkresore duke i bërë pjesë të fashikullit të gjykatës ;
- Neni 225 i K.Pr.Civile, nenet 6, 155, 157/c të K.Familjes në lidhje me vendimmarrjen, bazuar në natyrën e çështjes, që të caktojë ekspert psikolog për të dhënë mendim lidhur me përcaktimin e kushteve më të mira për mirërritjen e fëmijës²⁷;
- Nenet 125, 302 të K.Pr.Civile lidhur me hapin procedural të dhënë fund hetimit gjyqësor dhe ka ftuar palët të parashtrojnë diskutimin përfundimtar;
- Neni 106 i K.Pr.Civile lidhur me shpenzimet gjyqësore të kryera gjatë gjykimit²⁸;

(ii) Në vendimet gjyqësore penale (kërkesa penale), gjyqtari identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në pjesën e posaçme të Kodit Penal, në funksion të vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet personit. Konkretisht identifikohen :

- Neni 130/a i Kodit Penal në lidhje me akuzën “Dhuna në familje”²⁹;
- Neni 277 i Kodit Penal në lidhje me akuzën “Vetëgjyqësia”³⁰;
- Neni 140 i Kodit Penal në lidhje me akuzën “Vjedhja me armë”³¹;
- Neni 278/2 i Kodit Penal në lidhje me akuzën “Armëmbajtje pa leje”³²;

²³ Vendimi nr. 2092, datë 15.03.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

²⁴ Vendimi nr. 7756, datë 15.10.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

²⁵ Vendimet nr. 5785, datë 10.07.2015; nr. 6862, datë 08.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

²⁶ Në të gjitha seancat përgatitore, si dhe në vendimet e ndërmjetme të zbardhura si akte procedurale më vete “Për

kalimin e çështjes në seancë përgatitore ose gjyqësore”.

²⁷ Në të gjitha proceset gjyqësore, për shqyrtimin e çështjeve civile me natyrë marrëdhënie familjare, me fëmijë të mitur.

²⁸ Thuajse në të gjitha vendimet gjyqësore burim vlerësimi.

²⁹ Vendimi nr. 2510 akti, datë 08.10.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

³⁰ Po aty.

³¹ Vendimi nr. 2634 akti, datë 20.10.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

³² Po aty.

Në lidhje me identifikimin e dispozitave procedurale penale, gjyqtari referon, si pjesë të integruar të arsytimit të vendimit, dispozita të ligjit procedural penal, konkretisht :

- Nenet 251, 252 të K.Pr.Penale që kanë të bëjnë me «Arrestimin në flagrancë» dhe « Gjendjen e flagrancës» (duke cituar vetëm numrat e neneneve dhe jo përmbajtjen), për të vlerësuar se gjykata duhet të vleftësojë si të ligjshëm ndalimin e personit nën hetim, pasi rezulton të jetë kapur në kryerjen e sipër të veprës penale, megjithëse në një rast objekti i kërkesës është vleftësim arresti në flagrancë dhe në një rast tjetër vleftësim ndalimi³³ . Pra rezulton se gjyqtari bën referim të gabuar të ligjit në një rast, pasi ndodhet para një ndalimi, pra jo arrestim në flagrancë, ndërkohë që duhet të referonte dispozitat 253, 254 të K.Pr.Penale dhe kur është arresti në flagrancë, shprehet për vleftësim ndalimi, duke dhënë kuptimin e flagrancës, në kryerjen e sipër të veprës penale.
- Nenet 228, 229 të K.Pr.Penale në lidhje me ekzistencën e kushteve për caktim mase sigurimi personal shtrënguese³⁴;
- Neni 238 i K.Pr.Penale në lidhje me ekzistencën e kushteve për caktimin e masës shtrënguese ekstreme³⁵.

Krahas dispozitave të Kodit Penal dhe K.Pr.Penale, gjyqtari ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm, edhe disa dispozitash të akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës:

- nenet 6, 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në respektim të parimit të një procesi të rregullt ligjor, dhe mbrojtjes së e privatësisë dhe jetës së qetë private e familjare³⁶;
- nenet 3, 4, 12, 31, 173 të ligjit nr. 104/2012 për ratifikimin e Konventës të Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, në lidhje me masat mbrojtëse në rastet e shqyrtimit të padive për lëshim urdhër mbrojtje dhe në rastet e padive për zgjidhje martesë, në lidhje me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore³⁷.

Përgjithësisht konstatohet se dispozitat e Kodeve dhe ligjeve të identifikuar nga gjyqtari referohen vetëm si numra dhe në disa vendime (të cilat duket se nuk janë modele që përdor gjyqtari), përshkruhet përmbajtja e dispozitës konkrete që referohet nga gjyqtari.

Sa i përket aspektit të evidentimit të konfliktit të normave, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtari ndonjë rast konflikt i normave

³³ Vendimi nr.2510 akti, datë 08.10.2016 dhe nr. 2634 akti, datë 20.10.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

³⁴ Vendimet nr. 2510 akti, datë 08.10.2016; nr. 2634 akti, datë 20.10.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

³⁵ Po aty.

³⁶ Vendimi nr. 7756, datë 15.10.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

³⁷ Vendimet nr. 1951, datë 11.02.2014; nr. 1411, datë 25.02.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret.

Lidhur me këtë tregues, nga përmbajtja e kundërshtimeve konstatohet se gjyqtari ka paraqitur kundërshtime duke shpjeguar se nuk është dakord për vlerësim e kryer si për këtë tregues ashtu dhe në tërësi për krieterin “*Aftësitë profesionale të gjyqtarit*”, pasi në vlerësimin e tij të gjitha vendimet që janë marrë në analizë tregojnë qartë se ai si gjyqtar ka aftësi në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjeve, vendimet kanë të përshkruar pjesën hyrëse, kompetencën lëndore dhe tokësore, kanë pretendimet e palëve, pjesën arsyetuese të vendimit, i cili përgjithësisht bëhet për të mbështetur konkluzionin e dhënë nga gjykata lidhur me zgjidhjen e çështjes, bazën ligjore ku gjykata mbështet konkluzionin e arritur si dhe pjesën urdhëruese të qartë dhe të kuptueshme. Për sa i përket ligjit ku mbështet gjykata sqaron se ai bën një vendim që të jetë sa më i thjeshtë dhe i kuptueshëm nga palët për çështjen konkrete dhe nuk bën një vendim që është i “mbushur me ujra” dhe palët nuk arrin ta kuptojnë atë. Nga ana tjetër në projektraport thuhet se megjithëse vendimet kanë ngelur në fuqi ato kanë disa nga gjetjet e mësipërme, kur në fakt në shkallën hierarkike është Gjykata me e Lartë ajo që e vlerëson vendimin e gjykatës më të ulët në të gjithë komponent e saj. Gjithashtu, vlerëson se konkluzionet e projektraportit mbështeten në vlerësimet që ka bërë KPK, kur në fakt këto janë dy vlerësime të ndryshme me metodika të ndryshme që janë bërë nga grupe të ndryshme vlerësimi dhe për këtë arsye kjo barazvleshmeri nuk ekziston. Për sa më sipër kërkon që të shikohet dhe njuhërë vlerësimi për të gjithë kriterin e “aftësitë profesionale të gjyqtarit” .

Lidhur me këto kundërshtime, Këshilli vlerëson të sqaroi se vlerësimi për këtë tregues si dhe të gjithë kriterin “Aftësitë profesionale” bëhet mbi bazën e burimeve të vlerësimit të administruar gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar si dhe të 6 dosjeve të tjera të përzgjedhura me short. Në kryerjen e vlerësimit, vlerësuesi, mbështetet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit, bazuar në vendimet e përzgjedhura short dhe të përzgjedhura nga gjyqtari, pa vlerësuar meritat ligjore të vendimeve që vlerësohen vetëm nga një gjykatë më e lartë në kuadër të një procesi ankimi si dhe referuar parashikimeve të bërë në ligjin nr.96/2016 “Për Statusin” si dhe në rregullat e përcaktuara në “Metodologjinë e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit” të miratuar me vendimin nr.264, datë 21.11.2019 të KLGJ.

Gjithashtu, vlerësimi i kryer nga Këshilli, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën vlerësimit 2013 - 2016, analizohen duke mbajtur parasysh nenin 171, pika 5, e Ligjit për Statusin, në të cilin parashikohet se: “5.Pas vlerësimit të aftësive profesionale, të kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në kuadër të procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ose Kolegji i Apelimit, në rast se është ushtruar e drejta e ankimit, i dërgon Këshillit dosjen me vlerësimin e kryer të magjistratit, çdo dokument të përdorur në vlerësimin e aftësive profesionale, si dhe vendimin e formës së prerë të procesit të rivlerësimit. Nëse magjistrati kalon me sukses procesin e rivlerësimit, Këshillat vazhdojnë të bëjnë vlerësimin etik dhe profesional të magjistratëve, në zbatim të ligjit, për aq sa është e mundur, me qëllim që të përcaktojnë gradën e vlerësimit përkatës”

sipas të cilit Këshilli bën vlerësimin e gjyqtarit mbi bazën e të gjithë të dhënave të përdorur nga organet e rivlerësimit për vlerësimin e aftësive profesionale të gjyqtarit si dhe në vendimin e formës së prerë të procesit të rivlerësimit, por nuk mbështeten tek konkluzionet e këtyre organeve. Në referim të këtij neni, analiza dhe konkluzionet e vendimit të formës së prerë të organeve të rivlerësimit kalimtar konsiderohen të plota në lidhje me burimet që janë analizuar në kuadër të këtij procesi, vetëm në drejtim të qëllimit të identifikimit të gjyqtarëve që kanë arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, pra përfundimet e arritura konsiderohen vetëm në nivelin “majftueshëm” dhe është Këshilli ai që më pas përcakton nivelet e vlerësimit bazuar në burimet e vlerësimit, duke përcaktuar nivele të ndryshme si; “shkëlqyeshëm”, “shumë mirë”, “mirë” apo “mjaftueshëm”.

Në lidhje me elementët që janë konstatuar nga burimet e vlerësimit lidhur me këtë tregues, janë përshkruar në mënyrë të detajuar në raportin e vlerësimit dhe nuk u konstatua ndonjë element tjetër i ndryshëm.

KONKLUZIONI

Në tërësi, rezulton se gjyqtari ka aftësi të mesatare në paraqitjen fakteve, si atyre me natyrë procedurale në rastet kur ata kanë qenë objekt i diskutimit apo të vlerësuara kryesisht nga gjykata, në të cilat jep një panoramë të qartë të ecurisë së çështjes dhe veprimeve të kryera, ashtu edhe të fakteve thelbësorë të çështjes, të cilat përgjithësisht paraqiten në mënyrë të përmbledhur, dhe në disa raste duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar e vlerësimit tërësor të tyre. Por nuk rezulton e njëjta aftësi e gjyqtarit si në raport me përshkrimin e plotë të fakteve të çështjes, të cilat në disa raste paraqiten sipas përshkrimit të padisë ashtu dhe në raport me analizën e tyre. Gjyqtari ka aftësi të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimi i cili përgjithësisht bëhet për të mbështetur konkluzionin e dhënë nga gjykata lidhur me zgjidhjen e çështjes. Por nuk konstatohet e njëjta aftësi e gjyqtarit, pasi në disa vendime, gjyqtari nuk ka identifikuar ligjin e zbatueshëm për zgjidhjen e çështjes, por pas përshkrimit të rrethanave të çështjes, të cilat janë përshkruar sipas përshkrimit të bërë në kërkesë padi dhe shpjegimet e palës paditëse (duke referuar në vendim edhe pretendimet e palëve lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesë padisë, si dhe bazën juridike ku ata mbështetin pretendimet e tyre), gjyqtari ka konkluduar lidhur me zgjidhjen e çështjes. Ndërsa në dy vendimet me objekt vleftësim arresti / ndalimi dhe caktim mase, duket se dispozitat janë referuar në mënyrë të gabuar, pasi megjithëse përmendet vleftësim ndalimi, konkludohet se ndalimi është kryer në kryerjen e sipër të veprës penale (gjendje që lidhet me flangrancës).

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin normave” vlerësohet “mesatare”, dhe pikëzohet me 15 pikë.

1.A.B. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Interpretimi i ligjit është ekskluzivitet i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke i dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet t'u japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre, në funksion të zgjidhjes së çështjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë :

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve konkludohet si më sipër, cituar në treguesin 1.a.a "*Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave*".

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*procedurale dhe materiale - civile apo penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, në disa raste bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtari lidhur me zbatimin e saj, ndërsa në disa raste në shërbim të konkluzionit të dhënë nga gjyqtari për zgjidhjen e çështjes. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar në disa rast (në disa vendime që ndryshojnë nga modelet e zakonshme të gjyqtarit- 3 vendime të tilla), me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes, si në ato me natyrë procedurale, ashtu edhe në ato që kanë lidhje me themelin e çështjes. Në këto raste, interpretimi i dispozitave materiale/procedurale përgjithësisht bëhet nga ana e gjyqtarit, sipas mënyrës së interpretimit të tyre, në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Ndërsa në pjesën më të madhe të vendimeve, normat ligjore janë cituar në raport me faktet e çështjes, apo për të mbështetur konkluzionin lidhur me zgjidhjen e çështjes, dhe mungon interpretimi i tyre.

- *Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm*

Në vendimet gjyqësore civile: Në disa vendime burim vlerësim (në disa vendime me objekt zgjidhje martesë dhe përmbushje detyrimi, vendime të cilat ndryshojnë nga modelet e tjera të gjyqtarit, tre të tilla), interpretimi i disa normave juridike bëhet si në aspektin abstrakt të saj, duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative që të gjejë zbatim pretendimi dhe kërkimi i palës, duke i renditur në çdo rast, si dhe në përputhje me faktin dhe provat e lejuara e të marra në shqyrtim. Ndërsa në disa raste, normat citohet apo referohen për të mbështetur konkluzionin e gjykatës, pa bërë më parë një interpretim abstrakt të tyre apo se si këto norma zbatohen në raport me rrethanat konkrete të çështjes. Konkretisht, në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi evidentohet se gjyqtari :

- Interpreton nenet 1, 6, 55, 132, 133, 136, 143, 146, 155, 157, 158, 161 të Kodit të Familjes, në funksion të analizimit të fushës së zbatimit të këtij kodi, përkufizimit të marrëdhënies martesore dhe detyrimet që vijnë prej saj, shkëlqes së detyrimeve që vijnë nga martesë jetesa e përbashkët, parimin e interesit më të lartë të fëmijës së mitur, të drejtat dhe detyrimet e prindërve në lidhje me fëmijën e mitur, marrjen në konsideratë të mendimit të specializuar të ekspertit psikolog, kthimin ose jo të mbiemrit të vajzërisë, të drejtën e gjykatës për shtyrjen e shpalljes së vendimit deri në një vit kur nuk ka krijuar bindje se përjashtohet çdo mundësi pajtimi e bashkëshortëve, të drejtën për t'u shprehur në lidhje me fajësinë vetëm kur kjo kërkohet prej palëve, etj.³⁸. Gjithashtu, në mbështetje të konkluzionit për zgjidhjen e martesës, gjyqtari citon dhe interpreton dispozita të ligjit të posaçëm nr. 104/2012 për ratifikimin e Konventës të Këshillit të Europës "Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje", konkretisht nenet 31, 173 në lidhje me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore³⁹.
- Referon nenin 234 të Kodit të Familjes, për të mbështetur konkluzionin e arritur nga gjykata për tjetërsimin e pasurisë në emër të të miturit⁴⁰, por nuk bën një interpretim të saj.
- Identifikon si ligj të zbatueshëm Kodin Civil dhe citon e interpreton nenet 419, 445, 690, 698, në funksion të analizimit të fushës së zbatimit të këtij kodi, përkufizimit të marrëdhënies juridike të detyrimit, lindur nga kontrata e furnizimit, si një kontratë me detyrime të ndërsjellta e cila ka forcën e ligjit për palët⁴¹.
- Identifikon si ligj të zbatueshëm neni 625 i Kodit Civil, në funksion të konkluzionit se palës paditëse i është cënuar nderi, personaliteti dhe reputacioni i krijuar ndër vite, si një figurë publike, për të nxjerrë më tej konkluzionin përfundimtar se pala e paditur duhet të detyrohet të ndalojë publikimet në të gjitha format, pasi ato janë cenuesë të jetës private të palës paditëse⁴², por nuk ka bërë në interpretim të kësaj dispozite si në raport me kuptimin e saj ashtu dhe në raport me faktet e çështjes.

³⁸ Vendimet nr. 10036, datë 20.10.2014; nr. 1533, datë 02.03.2015; nr. 5408, datë 02.05.2014; nr. 4919, datë 17.04.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

³⁹ Vendimi nr. 10036, datë 20.10.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁴⁰ Vendimi nr. 3581, datë 18.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁴¹ Vendimet nr. 3004, datë 12.04.2016; nr. 2092, datë 15.03.2016; nr. 5785, datë 10.07.2015 të Gjykatës së Rrethit

Gjyqësor Tiranë.

⁴² Vendimi nr. 7756, datë 15.10.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- Në çështjet me natyrë marrëdhënie familjare, në shqyrtimin e padive me objekt lëshim urdhër të menjëhershëm mbrojtje, identifikon si ligj të zbatueshëm, ligjin nr. 9669, datë 18.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, duke cituar dispozita të tij, konkretisht nenet 10, 15, në funksion të konkluzioneve në lidhje me kompetencën për shqyrtimin e padisë, legjitimitetit e palës paditëse për ngritjen e padisë, vendimmarrjen për pranimin e shqyrtimit të provave me dëshmitarë gjatë gjykimit, argumentimin mbi masat mbrojtëse që do të caktojë në vendimmarrjen përfundimtare⁴³. Në mbështetje të këtyre konkluzioneve gjyqtari referon dhe citon dispozita (përmbjatjen e tyre) nga Konventa « Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, konkretisht nenet 3, 4, 12, e ratifikuar me ligji nr. 104⁴⁴. Gjithashtu, në këtë rast, Gjyqtari ka përdorur si ligj për të mbështetur vendimin e tij, pikërisht Konventën « Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje », duke mos identifikuar dispozitat procedurale dhe materiale në lidhje me këto lloj vendimesh të parashikuar nga K.Pr.Civile dhe ligji i posaçëm.

- Në lidhje me interpretimin e ligjit procedural të zbatueshëm

Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale civile dhe penale, gjyqtari në disa çështje i ka kushtuar rëndësi interpretimit të normës, jo vetëm sa i përket aspekteve të themelit të çështjes, por edhe atyre procedurale, në rastet kur ngrihen çështje të procedurës, apo kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel. Konkretisht:

(i) Në çështjet civile:

- Në funksion të evidentimit të marrëdhënies juridike, të krijuar mes palëve ndërgjyqëse identifikon dhe interpreton nenin 36 të K.Pr.Civile në analizë të juridiksionit gjyqësor të cilën gjykata ka për detyrë fillimisht ta shqyrtojë, nëse mosmarrëveshja hyn në juridiksionin gjyqësor dhe më pas të vlerësojë nëse ajo është kompetente për shqyrtimin e saj, në respektim të parimit të një procesi të rregullt ligjor, duke cituar nenet 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe 42 të Kushtetutës. Gjithashtu, gjyqtari referon edhe vendimin nr. 11, datë 08.01.2013 të Gjykatës së Lartë⁴⁵ ;
- Referon nenet 41, 42, 43, 47, 48, 51 të K.Pr.Civile në lidhje me kompetencën lëndore dhe tokësore të gjykatës në shqyrtimin e çështjes ; duke vijuar me nenin 359 të K.Pr.Civile (*nen ky i shfuqizuar me ligjin nr.9062, datë 8.5.2003*)) referuar objektit të padisë që e bën kompetente gjykatën për shqyrtimin. Në funksion të analizës së kompetencës së gjykatës, gjyqtari referon dispozita nga ligji nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe vendimin nr. 13, datë 08.01.2013 të Gjykatës së Lartë⁴⁶;

⁴³ Vendimet nr. 1951, datë 11.02.2014; nr. 1411, datë 25.02.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁴⁴ Vendimi nr. 1411, datë 25.02.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁴⁵ Vendimi nr. 1533, datë 02.03.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁴⁶ Po aty

- Interpreton nenet 31, 32/a të K.Pr.Civile në lidhje me legjitimitimin e palës për ngritjen e padisë, në bazë të së cilës do të përfitojë të drejtat pasurore juridiko civile⁴⁷;
- Citon në mënyrë literale dhe interpreton nenet 510, 511 të K.Pr.Civile në rastet e lëshimit të urdhërit të ekzekutimit bashkëngjitur vendimit përfundimtar i cili përmban një detyrim dhe përbën titull ekzekutiv i cili vihet në lëvizje nëpërmjet lëshimit të urdhërit të ekzekutimi, si dhe nenin 310 të K.Pr.Civile i cili dikton gjykatën në lidhje me vendimet e saj, për të cilat duhet të lëshojë urdhër ekzekutimi të shoqërojnë në çdo rast me kopje urdhri⁴⁸ ;

(i) *Në çështjet penale/kërkesa penale:*

- Referon dispozitat procedurale penale të sanksionuara në Kodin e Procedurës Penale, në lidhje me konceptin e flagrancës dhe vlerësimin që i bëhet masës shtrënguese më të përshtatshme që duhet të vendoset ndaj personit nën hetim (*nenet 228, 229 dhe 230 të K.Pr.Penale*) në lidhje me kushtet (*e përgjithshme dhe të veçanta*) dhe kriteret e caktimit të masave të sigurimit personal, por nuk bën një interpretim të këtyre dispozitave, si për të dhënë kuptimin e tyre ashtu dhe në raport me faktet e çështjes. Jo vetëm kaq, por gjyqtari në një rast edhe pse shprehet për vlefësimin e ndalimit, argumenton për gjendjen e flagrancës, që lidhet me arrestin në flagrancë dhe jo ndalimin e personit.

- *Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën relevante.*

Në vendimet e analizuara rezultojnë se gjyqtari ka identifikuar dhe përdorur në disa raste jurisprudencën relevante (*vendimet e Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, vendimet e GJEDNJ*), në mbështetje të konkluzioneve të tij, por jo të argumentit juridik që shpesh herë mungon, apo interpretimit ligjor, kryesisht në rastet si më poshtë:

a) Në respektim të parimit të një procesi të rregullt ligjor, duke cituar nenet 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe 42 të Kushtetutës, gjyqtari referon edhe vendimin nr. 11, datë 08.01.2013 të Gjykatës së Lartë⁴⁹ ;

c) Në mbështetje të konkluzionit për zgjidhjen e martesës dhe pasojat që rrjedhin prej saj, gjyqtari referon dhe citon dispozita nga ligji nr. 104/2012 për ratifikimin e Konventës të Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, konkretisht nenet 31, 173 në lidhje me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore⁵⁰. Gjithashtu dhe në çështjet për dhunë në marrëdhëniet familjare në mbështetje të analizës lidhur me masat mbrojtëse që do caktohen gjyqtari referon dhe citon dispozita nga ligji nr. 104/2012, konkretisht nenet 3, 4, 12⁵¹;

⁴⁷ Vendimet nr. 5785, datë 10.07.2015; nr. 2092, datë 15.03.2016; nr. 7756, datë 15.10.2015 të Gjykatës së Rrethit

Gjyqësor Tiranë.

⁴⁸ Vendimet nr. 5785, datë 10.07.2015; nr. 6862, datë 08.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁴⁹ Vendimi nr. 1533, datë 02.03.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁵⁰ Vendimi nr. 10036, datë 20.10.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁵¹ Vendimi nr. 1411, datë 25.02.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

d) Në funksion të analizës së juridiksionit gjyqësor të cilën gjykata ka për detyrë fillimisht ta shqyrtojë nëse mosmarrëveshja hyn në juridiksionin gjyqësor dhe më pas të vlerësojë nëse ajo është kompetente për shqyrtimin e saj, në respektim të parimit të një procesi të rregullt ligjor, duke cituar nenet 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe 42 të Kushtetutës, gjyqtari gjithashtu referon edhe vendimin nr. 11, datë 08.01.2013 të Gjykatës së Lartë⁵² ;

e) Në funksion të analizës së kompetencës së gjykatës në shqyrtimin e çështjes, pas referimit të nenit 359 të K.Pr.Civile (nen ky i shfuqizuar me ligjin nr.9062, datë 8.5.2003), referuar objektit të padisë, që e bën kompetente gjykatën për shqyrtimin e saj, gjyqtari referon dhe vendimin nr. 13, datë 08.01.2013 të Gjykatës së Lartë⁵³;

- Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës

Nga tërësia e vendimeve gjyqësore të analizuara, rezulton se gjyqtari gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, përgjithësisht zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet duke iu referuar kontekstit të arsyetimit dhe analizës ligjore të vendimit. Nga tërësia e vendimeve rezulton se gjyqtari njeh dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit, siç janë:

- *Parimet themelore të procesit gjyqësor civil të parashikuar në nenet 10, 11, 12, 14, 16 etj. (procesi i rregullt ligjor nëpërmjet zhvillimit të një hetimi gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm në çështjet civile, barra e provës, kontradiktoriteti, etj.), mbi bazën e të cilave gjykata disponon për bazueshmërinë ose jo të padisë.*
- *Parimin e interesit më të lartë të fëmijës së mitur, në zgjidhjen e çështjeve, mosmarrëveshje me natyrë familjare;*

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari përgjithësisht ka aftësi të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe kryesisht atij material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen. Interpretimi i ligjit procedural dhe atij material në disa vendime paraqitet i mirë (tek vendimet që konstatohet se nuk janë modeli i zakonshëm që përdor gjyqtari), ndërsa në disa vendime të tjera paraqitet tepër i kufizuar, kryesisht në raport me rrethanat e faktit dhe në disa raste mungon, pasi ligji është referuar vetëm për të mbështetur konkluzionin e arritur nga gjyqtari. Në shumicën e vendimeve burim vlerësimi dispozitat referohen dhe zbatohen drejtpërdrejt në mbi faktet e çështjes, apo për të mbështur konkluzionin e gjyqtarit, pa u bërë me parë një interpretim paraprak i tyre në drejtim të identifikimit të qëllimit, elementëve përbërës dhe zberthimit të tyre, pra gjyqtari përgjithësisht aplikon drejtpërdrejt ligjin mbi faktet e provuara në gjykim

⁵² Vendimi nr. 1533, datë 02.03.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁵³ Po aty

(të përshkruara në pjesën e parë të pjesës përshkruese-arsyetuese) duke integruar referimin e dispozitave në konkluzionet e arritura, pa u ndalur në interpretimin e ligjit dhe dhënien e arsyeve konkrete për mënyrën e zbatimit të tyre mbi faktet e çështjes. Megjithatë, evidentohet kujdesi i gjyqtarit për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, si dhe kujdesi për të zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor, kryesisht për të mbështetur konkluzionin e arritur nga gjyqtari mbi zgjidhjen e çështjeve konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “mesatare” dhe pikëzohet me 15 pikë.

1.B. Arsyetimi ligjor

1.B.A. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtarja, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin e vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GJEDNJ është shprehur se, megjithëse gjykatave i lejohej një liri e konsiderueshme veprimi, përsa i përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t'u ankuar⁵⁴.

Shkrimi ligjor duhet të karakterizohet nga disa tipare që e bëjnë të qëndrueshëm, siç janë: qartësia, saktësia, konciziteti dhe komponenti analitik. Ai duhet të paraqesë pa ndërprerje një pamje të qartë, të shpejtë dhe të plotë të çështjes. Vendimi gjyqësor nuk duhet të dominohet nga përshkrimi i provave, por nga pjesa analitike, e cila në vetvete duhet të jetë koncize, pa përsëritje dhe të trajtojë çështjet thelbësore.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

⁵⁴ Vendimi i GJEDNJ, çështja Dadjanastassion vs Greqisë, datë 16.12.1992, faqe 33.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Subjekti i rivlerësimit, gjyqtari Adriatik Bocaj ka aftësi të mira në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore të hartuara prej tij, në përgjithësi janë të qarta dhe të kuptueshme, por ndonjëherë tepër shkurt. Në përgjithësi respekton rregullat e drejtshkrimit, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor, por nuk i ka përdorur gjithmonë të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë paraqiten në gjatësi normale, janë të kuptueshme dhe me referenca ligjore”*.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se vendimet gjyqësore përgjithësisht janë të qarta dhe të kuptueshme, duke u bërë të kuptueshëm edhe për një lexues të arsyeshëm, jo vetëm për njohësit e ligjit.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve apo shprehjeve që mund cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues.

Në arsyetimin e vendimeve gjyqtari përgjithësisht zbaton rregullat gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Gjyqtari përgjithësisht përdor të gjitha shkronjat e gjuhës shqipe, (përveç shkronjës “ë” dhe “ç”), dhe vendimet janë shkruara përgjithësisht në mënyrë korrekte në aspektin gjuhësor. Fjalitë ndërtohen drejt dhe përgjithësisht janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, dhe paragrafët apo nënndarjet e arsyetimit të vendimit gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi, në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren.

Por konstatohet se jo gjithmonë gjyqtari përdor rregullat gramatikore në drejtshkrimin e saktë të fjalëve, që konsiston në drejtshkrimin e saktë të tyre, në ndërtimin e rregullt të fjalive⁵⁵.

Gjyqtari përdor fjali me gjatësi mesatare, duke shprehur mendimin përgjithësisht në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme dhe duke organizuar fjalitë në rrjedhë logjike me njëra-tjetrën. Por ndonjëherë qartësia dhe rrjedha e mendimit humbet për shkak të përsëritjes, mungesës së rrjedhshmërisë ndërmjet paragrafëve, apo mungesës së paragrafëve të mirëdallueshëm. Kjo mënyra e organizimit dhe shprehjes së mendimit në arsyetimin e vendimeve e vështirëson disi rrjedhshmërinë e vendimit, duke humbur në disa raste filli logjik.

Në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë së vendimit në pjesën përshkruese, konstatohet se në disa vendime, gjyqtari megjithëse shprehet se në dispozitiv lidhur me shpërblimin e dëmit, apo caktimin e të drejtave të takimit, apo të caktimit të masave të mbrojtjes në kundër

⁵⁵ Vendimi nr.1951, datë 1.02.2024, nr.3581, datë 18.03.2024, nr.1533, datë nr.1533, datë 02.03.2015, nr.7756, datë 15.10.2015, nr.5408, datë 02.05.2014, nr.4919, datë 17.04.2014.

të lëshimit të urdhërit të mbrojtje, nuk është shprehur për to në pjesën arsyetuese, duke i lenë të nënkuptuar disponimet e gjyqtarit në pjesën urdhëruese⁵⁶.

Në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë së vendimit, veç pjesës hyrëse dhe përshkruese arsyetuese të vendimit, evidentohet se në dispozitivin e vendimit gjyqtari përgjithësisht është shprehur në mënyrë të plotë dhe koncize gjitha kërkimet, shpenzimet gjyqësore, të drejtën e ankimit, afatin e ankimit dhe momentin e fillimit të tij. Në disa raste konstatohet se në vendim mungon evidentimi i shpenzimeve gjyqësore të realizuara gjatë gjykimit dhe në një rast gjyqtari është shprehur për një pjesë të tyre.

Ndërsa në vendimin nr.3581, datë 18.03.2014 me objekt lëshim autorizimi për tjetërsim pasurie, konstatohet se pjesa urdhëruese e vendimit nuk përputhet me objektin e kërkesës si dhe me pjesën arsyetuese në lidhje me emrin e fëmijëve për të cilën kërkohet autorizimi, me numrin e pasurisë, sipërfaqen e pasurisë si dhe vendodhjen e saj (identifikimi i pasurisë).

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi të mira në drejtim të treguesit të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Gjuha e përdorur dhe mënyra e organizimit të mendimit, përgjithësisht mndësojnë leximi të organizuar që ofron kalim nga njëra pjesë e vendimit tek tjetra në mënyrë logjike. Por nuk konstatohet e njëjta aftësi e gjyqtarit në të gjitha vendimet, për shkak të moszbatimit të saktë të rregullave gramatikore dhe ato të sintaksës si dhe të mospërdorimit të të gjitha shkronjave të alfabetit shqip por dhe mungesës në disa raste të rrjedhshmërisë në shprehjen e mendimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “mesatare”, dhe pikëzohet me 9 pikë.

1.B.B. Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.

Organizimi i arsyetimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj, do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kryesore të vendimit mund të humbasin apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsyetimi të ndjekë një format të qartë organizimi në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje

⁵⁶ Vendimi nr.6862, datë 08.09.2016, nr.1411, datë 25.02.2015, nr.1951, datë 11.02.2014

me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsytimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike që juristët/gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër, dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*), CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*) etj, të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/ pyetjen për zgjidhje, normën relevante që do të duhet të zbatohet për zgjidhjen saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzioni i arritur.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se : *“Struktura e vendimeve përfundimtare është e qëndrueshme, dhe në përgjithësi e standardizuar duke i shërbyer funksionit të qartësisë së argumentit ligjor. Vendimet përfundimtare të tij plotësojnë sipas rastit kërkesat e legjislacionit procedural civil (shih dokumentet 1 e 2 dhe dosjet 1, 2, 3 e 4) apo kërkesat e legjislacionit procedural penal (shih dokumentin 3 dhe dosjen 5). Në një rast u konstatua që në pjesën e fundit të vendimit, dispozitivi nuk përputhej me objektin e kërkesës, pasi si numri i pasurisë, sipërfaqja e saj dhe emrat e fëmijëve janë të ndryshëm me ata që janë përshkruar në pjesën hyrëse të vendimit (shih dosjen 3)”*.

Gjyqtari në hartimin e vendimit përgjithësisht ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, të cilës i përmbahet në prezantimin e fakteve në lidhje themelit të çështjes (jo atyre me natyrë procedurale), paraqitjen e pretendimeve të palëve në disa vendime, identifikimit të ligjit të zbatueshëm, dhënien e argumentit ligjor në disa raste, duke e lidhur me konkluzionin e arritur apo menjëherë pas identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhënien e konkluzionit të arritur lidhur me zgjidhjen e çështjes. Ndërsa në disa vendime (që nuk janë njëlloj si modelet e vendimeve të gjyqtarit)⁵⁷, konstatohet se vendimet janë të mirëstrukturuara, duke e ndarë pjesën përshkruese-arsyetuese në nënndarje, duke përshkruar fillimisht rrethanat procedurale, për të vijuar me nëndarjen “rrethanat e çështjes”, ku gjyqtari përshkruar rrethanat dhe faktet duke i gërshetuar me pretendimet e palëve,, më pas në nëndarjen “vlerësimi i gjykatës” e cila në disa raste paraqitet e nëndarë, në disa nënçështje. Megjithëse konstatohet se gjyqtari ndjek përgjithësisht një metodologji strukturimi të

⁵⁷ Vendimi nr.1533, datë 02.03.2015, vendimi nr.3004, datë 12.04.2016, nr.10036, datë 20.10.2014

pjesëve përbërëse të vendimit edhe pse jo në aspektin formal të saj, nuk konstatohet e njëjta metodologji strukturimi tek secili vendim. Në disa vendime burim vlerësimi mungon pasqyrimi i rrethanave të faktit, siç kanë rezultuar gjatë gjykimit, pasi ato janë përshkruar sipas përshkrimit të bërë nga pala, dhe në disa vendime mungon analiza juridike, pasi gjyqtari pas përshkrimit të rrethanave të faktit, kryesisht ato që lidhen me themelin e çështjes, dhe identifikimit të ligjit të zbatueshëm (përshkrim që në disa raste është bërë sipas përshkrimit të bërë nga pala paditëse), jep konkluzionet përkatëse lidhur me zgjidhjen e çështjes⁵⁸.

Karakteristike në disa vendimeve të gjyqtarit është se kalohet nga përshkrimi i fakteve të çështjes, të cilat siç u theksua më lartë jo gjithmonë paraqiten të plotë dhe identifikimin e ligjit të zbatueshëm në disa raste , në mënyrë të drejtpërdrejtë në konkluzionin e arritur për zgjidhjen e çështjes, pa analizuar ligjin e aplikueshëm, duke ndikuar kështu në qartësinë dhe plotësinë e vendimit, pasi në thelb vendimi duhet të evidentohet edhe në aspektin përmbajtësor, ku një strukturë e qëndrueshme dhe e mirë organizuar duhet të përmbajë të gjithë elementët e saj, në funksion të qartësisë, plotësisë, qëndrueshmërisë dhe kuptueshmërisë së aktit si dokument ligjor.

Megjithatë vendimet gjyqësore burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit e çështjes, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data e shqyrtimit, palët, përfaqësuesit e tyre, prezenca ose mungesa e tyre në seancë, objekti i shqyrtimit (*padisë ose kërkesës në çështjet civile dhe objekti i kërkesës në çështjet penale*) baza ligjore si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, të paraqitura në mënyrë të përmbledhur. Në një vendim⁵⁹, të dhënat lidhur me palën e paditur nuk janë pasqyruar të sakta sipas kërkesë padisë, dhe sipas vendimit që ka disponuar gjykata, pasi si palë e paditur është shënuar gjeneralitetet e një personi që nuk ka lidhje me çështjen.

Pjesa përshkuuese-arsyetuese e vendimit përgjithësisht organizohet në një strukturë të qëndrueshme dhe unike, e ndarë në disa raste me paragrafë, të cilët përgjithësisht vijjnë në një rrjedhe logjike dhe në disa vendime e ndarë në pjesë apo nënpjesë me tituj apo me fjali hyrëse përshkruese. Mënyra e organizimit të pjesës përshkuuese-arsyetuese të vendimeve burim vlerësimin ndjek përgjithësisht këtë renditje:

- (i) *prezantimi e çështjes* ku përgjithësisht e cilëson që jemi përpara një çështje civile dhe prezantimin e padisë me të cilën paditësi i është drejtuar gjykatës. Gjyqtari përgjithësisht nuk bën një prezantim të ecurisë procedurale të çështjes. Ndërsa në disa vendime, evidentohen se gjyqtari bën një prezantim të ecurisë procedurale të çështjes, si dhe të aspekteve procedurale të marra në shqyrtim (kryesisht tek vendimet që nuk janë si

⁵⁸ Vendimi nr.7756, datë 15.10.2015, nr.5785, datë 10.07.2015

⁵⁹ Vendimi nr.4919, datë 17.04.2014

modelet e gjyqtarit), ku konstatohet se gjyqtari është zgjatur në evidentimin e tyre, krahasur edhe në raport me pjesët e tjera të vendimit.

- (ii) *Rrethanat e faktit.* Rezulton që prezantimi i faktit në disa vendime është paraqitur në pjesën e parë të vendimit, ku në disa raste referohen dhe provat e administruara dhe të marra në shqyrtim megjithëse jo të plota. Në disa vendime, në këtë pjesë të vendimit pasqyrohen edhe pretendimet e palës paditëse, duke i gërshetuar ato me rrethanat e faktit, pa i paraqitur më vete. Ndërsa pretendimet e parashtruar nga pala e paditur kryesisht mungojnë. Ndërsa në disa vendime, rrethanat dhe faktet janë paraqitur sipas përshkrimit të palës paditëse/ kërkuese, ku gjyqtari ka përshkruar edhe qëndrimet e kësaj pale lidhur me padinë, duke referuar edhe bazën juridike të kërkimit të tyre, duke mos i evindetuar këto si qëndrime të kësaj pale por duke i pasqyruar si arsyetim të gjykatës.
- (iii) *Vlerësimi i gjykatës* lidhur me çështjen (*edhe pse në vendime nuk gjendet me këtë titull, veç tre vendimeve që nga pamja konstatohet se nuk janë modelet e gjyqtarit*). Pas evidentimit të fakteve të çështjes, në ato raste kur ato evidentohen qartë, si dhe përshkrimit të pretendimeve të palës paditëse, arsyetimi vijon në disa raste me identifikimin e ligjit të zbatueshëm, duke evidentuar në disa raste kushtet e nevojshmë që duhet të plotësohen në rastin konkrete dhe përqasjen e tij me faktet e provuar në gjykim (kryesisht tek vendimet që nuk janë model i gjyqtarit), për të vijuar me konkluzionin lidhur me bazueshmërinë ose jo në ligj të padisë. Ndërsa në pjesën më të madhe të vendimeve, pas identifikimit të ligjit të zbatueshëm, gjyqtari paraqet konkluzionin e arritur për zgjidhjen e çështjes, duke e paraqitur atë si një konkluzion të arritur pas përshkrimit të fakteve, pa bërë më parë një analizë të dispozitave, në raport me faktet e çështjes. Pra në këto vendime mungon pjesa e paraqitjes së provave, referimi i dispozitave ligjore apo referimi i tyre i saktë dhe i plotë, si dhe dhënia e arsyeve mbi të cilat gjyqtari mbështetet vendimi e tij.
- (iv) *Në pjesën e dispozitivit*, gjen pasqyrim disponimi i gjykatës në lidhje me pranimin/ rrëzimin e padisë, përcaktimin e detyrimeve të palës së paditur, në rastet kur padia është pranuar tërësisht ose pjesërisht, përcaktimi i cilësisë së vendimit si titull ekzekutiv, disponimin për shpenzimet gjyqësore, dhe të drejtën e ankimit. Në një vendim është konstatuar se pjesa urdhëruese e vendimit nuk ka lidhjen me pjesën tjetër, pasi emri i të miturve dhe pasuria nuk përputhen me palët ndërgjyqëse.

Referuar strukturës dhe përmbajtjes së arsyetimit të vendimit, rezulton se në arsyetimin e vendimit nuk elaborohet mjaftueshëm dhe nuk zë vendin e duhur në përmbajtje vlerësimi dhe analiza juridike e çështjes, pjesë në të cilën do të duhet të merrej në analizë ligji i zbatueshëm, zbërthimi i tij, mënyrë e aplikimit mbi faktet e çështjes, për të derivuar në tej në konkluzionin e arritur për zgjidhjen e çështjes, të cilin gjyqtari e paraqet në shumicën e vendimeve, menjëherë pas përshkrimit të faktit objekt gjykimi.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi “mesataren” në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit sipas pjesëve përbërëse të tij. Në një pjesë të vendimeve të analizuara

konstatohet se ndjekja e një strukture të njëjtë, të mirëpërcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, i bën vendimet lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme dhe orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tyre. Ndërsa në disa vendime nuk konstatohet se gjyqtari nuk ndjek një strukturë të qartë të vendimit, të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike. Nga ana tjetër në strukturën e pjesës arsyetuese, kalimi në shumicën e rasteve nga përshkrimi i fakteve të çështjes dhe identifikimi i ligjit të zbatueshëm, në mënyrë të drejtpërdrejtë në konkluzionin e arritur për zgjidhjen e çështjes, pa analizuar ligjin e aplikueshëm, ndikon në qartësinë dhe plotësinë e vendimit, pavarësisht se në dukje aspekti strukturor i ndërtimit të tij mund të duket i qartë, por nuk mund të vlerësohet në të njëjtën mënyrë edhe për plotësinë e tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit” vlerësohet “mesatare”, dhe pikëzohet me 6 pikë.

1.B.C. Cilësia e analizës dhe argumentit logjik.

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitiv të vendimit duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se : *“Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës, në raport me pretendimet e ngritura nga palët. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore, por nuk plotësohet me pjesë nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë. Një konstatim i punës së tij, është fokusimi i arsyetimit të vendimit tek thelbi i çështjes dhe konkretizimi sipas rastit në mosmarrëveshje, pa përdorur fjali të përgjithshme apo arsyetim i tepërt mbi çështje të konsoliduara nga praktika dhe doktrina.*

Niveli i arsytimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nuk është identifikuar asnjë rast nga 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, që të jetë cenuar vendimi nga Gjykata e Apelit ose Gjykata e Lartë, për shkak të procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Në dispozitivin e vendimit, në të gjitha rastet e vëzhguara, është konstatuar se disponohet për shpenzimet procedurale/gjyqësore, si dhe tregohet e drejta e ankimit për palët.

Gjithashtu, tek 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se ai i kushton rëndësinë e duhur arsytimit të vendimeve të ndërmjetme. Në çdo rast, vendimet e ndërmjetme jepen me tekst të qartë arsyetimi, duke referuar shkakun, por jo gjithmonë edhe bazën ligjore”.

Në vendimet e analizuara, përgjithësisht rezulton një nivel nën mesatar i arsytimit, duke shqyrtuar, argumentuar në pak raste dhe konkluduar për çdo element të nevojshëm të vlerësuar nga gjyqtari në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t'u analizuar apo për të konkluduar në shumicën e rasteve në raport me aspektet procedurale të gjykimit, kryesisht lidhur me kërkesat për vleftësim arresti/ndalimi dhe caktim mase sigurimi personal.

Arsyetimi i vendimeve përfundimtare, pas përcaktimit të fakteve të çështjes, të cilat përgjithësisht paraqiten në mënyrë të saktë, në pak vendime zhvillohet mbi bazën e një analize juridike të shkurtër të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material (civil apo penal), duke bërë një analizë tërësore dhe të përmbledhur të provave të administruara, në funksion të konkluzionit të arritur nga gjykata. Konstatohet se në pjesën më të madhe të vendimeve⁶⁰, gjyqtari pas përshkrimit të fakteve të çështjes dhe identifikimit në disa raste të ligjit të zbatueshëm, del direkt në konkluzionet përkatëse për zgjidhjen e çështjes, si një sintezë e fakteve dhe provave të përshkuara nga gjyqtari në pjesën e parë të vendimit, pa bërë një analizë të fakteve dhe provave të marra në shqyrtim. Në këto vendime, konkluzioni i paraqitur në fund të pjesës arsyetuese mbi zgjidhjen e çështjes, nuk është paraprirë nga arsyet dhe mënyrën e aplikimit të ligjit mbi faktin e provuar në gjykim. Pra gjyqtari nuk bën një analizë të dispozitave dhe koncepteve ligjore të së drejtës materiale apo procedurale, por pas referimit të ligjit të zbatueshëm e zbaton atë drejtpërdrejtë mbi faktet e provuara në gjykim, të cilat gjithashtu siç u arsyetua më lartë jo gjithmonë përshkruhen në mënyrë të plotë.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve.

Arsyetimi i vendimeve përgjithësisht është i qartë dhe gjithëpërfshirës, duke marrë në analizë dhe duke i dhënë përgjigje pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse, të cilat janë në disa raste janë përshkruar në mënyrë të përmbledhur nga gjyqtari duke i ndërthurur me rrethanat e faktit, ndërsa në disa raste paraqitet të nënkuptuar në raport me kërkimet e

⁶⁰ Vendimi nr.1411, datë 25.02.2015, nr.1951, datë 11.02.2014, nr.3581, datë 18.03.2014, nr.7756, datë 15.10.2015, 6862, datë 08.09.2016, nr.5785, datë 10.07.2015

pranuara në padi. Por nuk konstatohet gjithmonë një përshkrim i pretendimeve të palëve dhe thuajse në të gjitha rastet mungon një analizë lidhur me bazueshmërinë ose jo të pretendimeve të palëve, si në raport me arsyetimin e koncepteve ligjore dhe zbërthimin e këtyre koncepteve në raport me rrethanat e provuara dhe provat përkatëse ku palët bazojnë pretendimet e tyre. Në shumicën e rasteve, gjyqtari pas përshkrimit të rrethanave të faktit, dhe identifikimit të ligjit të zbatueshëm, të identifikuar nga gjyqtari në vendimet përkatëse, del në konkluzionet përkatëse mbi bazueshmërinë ose jo të kërkimeve të palëve apo të padisë (duke u shprehur në disa raste se gjykata mendon apo çmon se padia është e bazuar në prova e në ligj e si e tillë duhet të pranohet apo thjesht se padia duhet të pranohet) dhe më pas kërkimet e pranuara cilësohen në dispozitiv.

KONKLUZIONI

Sa më sipër, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre për këtë tregues vlerësohet se gjyqtari në shumicën e vendimeve nuk ka kryer një analizë të plotë dhe të detajuar të provave në raport me ligjin e zbatueshëm. Arsyetimi i vendimeve gjyqësore mbështetet kryesisht në vlerësimin e gjyqtarit mbi faktet e çështjes të përshkruar në pjesën e parë të vendimit kur përshkruhen rrethanat dhe faktet (të cilat siç e theksuam më lart jo gjithmonë janë përshkruar ashtu siç kanë rezultuar gjatë gjykimit), duke bazuar konkluzionin për zgjidhjen e çështjes si deduksion të fakteve të përshkruara dhe pretendimeve të palëve, por pa integruar dhe mbështetur këtë të fundit në interpretimin dhe dhënien e argumenteve mbi mënyrën e aplikimit të ligjit mbi faktin konkret. Analizës, interpretimit dhe aplikimit të ligjit mbi faktet konkrete duhet t'i kushtohet rëndësi me e madhe nga gjyqtari i cili bën një vlerësim të përgjithshëm dhe përshkruet, duke mos u treguar kujdesi i duhur në analizën e fakteve dhe aplikimin e ligjit, duke rezultuar kështu që disa vendime të mos jenë mbështetur mirë në argumente logjike dhe ligjore.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “cilësia e analizës dhe argumentit logjik” vlerësohet “nën mesatare” dhe pikëzohet me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtarit”

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
55	Mirë

2. AFTËSIA ORGANIZATIVE E GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij, si kur gjykon i vetëm, ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

2.A.A. Respektimi i afateve ligjore

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se : “ Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtari Adriatik Bocaj ka qenë gjithnjë brenda afateve standard apo ligjore dhe në interval kohore nga 1 ditë (shih dosjen 5) deri në 5 muaj e 1 ditë (shih dosjen 1). Në tre dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 1 muaj e 20 ditë (shih dosjen 4), 2 muaj e 3 ditë (shih dosjen 2) dhe 19 ditë (shih dosjen 3). Në 5 dosje të vëzhguara, është konstatuar se është respektuar standardi i procesit të rregullt ligjor.

Përsa i përket kohëzgjatjes së gjykimeve në 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, rezulton se në një rast kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 5 muaj, jashtë afatit standard 4 mujor (shih dokumentin 2). Në dy rastet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 15 ditë, pra brenda afatit standard (shih dokumentin 1) dhe në rastin tjetër 2 ditë, brenda afatit ligjor (shih dokumentin 3) ”.

- **Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se:**

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e

gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar çështjeve të përzgjedhura me short dhe tre vendimeve të zgjedhura nga gjyqtari.

Në Kodin e Procedurës Civile, për çështjet civile të themelit, në përgjithësi nuk parashikohet afat ligjor, për përfundimin e tyre. Por disa raste, referuar natyrës së çështjes, e cila shqyrtohet bazuar në parashikimet e ligjit të posaçëm, jemi para afateve ligjore për përfundimin e tyre. Edhe në Kodin e Procedurës Penale nuk parashikohet afat ligjor për gjykimin e çështjeve penale të themelit, por në disa raste parashikohet afat për shqyrtimin e kërkesave penale.

Nga vëzhgimi i 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se vetëm për 4 (katër) prej tyre, parashikohet afat ligjor, brenda të cilit duhet të përfundojë gjykimi i çështjes. Konkretisht:

- Çështja/kërkesa penale nr. 2510 regjistri, datë regjistrimi 07.10.2016, që i përket palës kërkuese Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë të shtetasit S.Q. dhe caktimin e masës së sigurimit personal ndaj tij “arrest në burg”, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a/1 i K.Penal, përfunduar me vendimin nr. 2510 akti, datë 08.10.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për shqyrtimin e kësaj kategorie çështjeje parashikohet si afat ligjor për përfundimin e gjykimit, afati 48 orë nga momenti i regjistrimit të kërkesës në gjykatë, sipas nenit 259/5 të K.Pr.Penale⁶¹. Referuar akteve të dosjes që i përket këtij vendimi gjyqësor penal, rezulton se kërkesa për vleftësimin e arrestimit dhe caktimin e masës së sigurimit është regjistruar në gjykatë më datë 07.10.2016 dhe ka përfunduar së gjykuari më datë 08.10.2016, pra **brenda afatit ligjor** prej 48 orësh, të parashikuar në nenin 259/5 të K.Pr.Penale.
- Çështja/kërkesa penale nr. 2634 regjistri, datë regjistrimi 19.10.2016 (*kjo datë regjistrimi del nga përmbajtja e arsytimit të vendimit gjyqësor i cili është vendim i zgjedhur për vlerësim nga vetë subjekti/gjyqtari*), që i përket palës kërkuese Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt vleftësimin e ligjshëm të ndalimit të shtetasit G.G. dhe caktimin e masës së sigurimit personal ndaj tij “arrest në burg”, si i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Vjedhje me armë” dhe “Armëmbajtje pa leje”, parashikuar nga nenet 140, 278 të K.Penal, përfunduar me vendimin nr. 2634 akti, datë 20.10.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për shqyrtimin e kësaj kategorie çështjeje parashikohet si afat ligjor për përfundimin e gjykimit, afati 48 orë nga momenti i regjistrimit të kërkesës në gjykatë, sipas nenit 259/5 të K.Pr.Penale. Referuar përmbajtjes së arsytimit të vendimit gjyqësor penal nr. 2634 akti, datë 20.10.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se kërkesa për vleftësimin e arrestimit dhe caktimin e masës së sigurimit është regjistruar në gjykatë më datë 19.10.2016 dhe ka përfunduar së gjykuari më

⁶¹ Neni 259 i K.Pr.Penale parashikon se : “...5. Arrestimi ose ndalimi e humbet fuqinë kur vendimi i gjykatës për vleftësimin nuk është shpallur brenda dyzet e tetë orëve të ardhshme nga çasti në të cilin kërkesa e prokurorit është paraqitur në gjykatë”.

datë 20.10.2016, pra **brenda afatit ligjor** prej 48 orësh, të parashikuar në nenin 259/5 të K.Pr.Penale.

- Çështja e kategorisë civile/ familjare, që i përket vendimi gjyqësor civil nr. 1951, datë 11.02.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhënë në përfundim të shqyrtimit të çështjes civile që i përket palëve ndërgjyqëse : palë paditëse P.C. etj., kundër palës së paditur Sh.C., me objekt lëshim urdhër mbrojtje (të dhënat dalin nga përmbajtja e arsytimit të vendimit gjyqësor i cili është vendim i zgjedhur për vlerësim nga vetë subjekti/gjyqtari). Për shqyrtimin e kësaj kategorie çështjeje parashikohet si afat ligjor për përfundimin e gjykimit, afati 15 ditor nga pranimit i kërkesës, sipas nenit 16/1 të Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar⁶². Referuar përmbajtjes së vendimit gjyqësor të arsyetuar, rezulton se gjykimi për lëshimin e urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes ka përfunduar brenda afatit 15 ditor (kërkesa është depozituar më datë 27.01.2014 dhe vendimi për lëshimin e urdhërit të mbrojtjes është shpallur më datë 11.02.2014).
- Çështja civile/ familjare nr. 5067 regjistri, datë regjistrimi 27.01.2015, me objekt lëshim urdhri i menjëhershëm mbrojtje, përfunduar me vendimin nr. 1411, datë 25.02.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si çështje e kategorisë civile të përgjithshme, referuar akteve të dosjes gjyqësore që i përket këtij vendimi, rezulton se për shqyrtimin e saj gjyqtari me vendimin e datës 27.01.2015⁶³ (ditën e caktimit të çështjes me short), ka vënë në lëvizje çështjen duke caktuar seancën gjyqësore më datë 28.01.2015 (kërkesa është depozituar më datë 27.01.2015 dhe vendimi për lëshimin e urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes është shpallur më datë 28.01.2015. Ndërkohë, në vendimmarrjen e datës 28.01.2015 gjykata ka caktuar edhe datën e seancës për vërtetimin e urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes, në respektim të afatit 20 ditor prej lëshimit të tij me vendim gjykate, konkretisht data 09.02.2015)⁶⁴. Në seancën për verifikimin e urdhrit të lëshuar, gjykata ka vendosur të marrë prova me dëshmitarë dhe për këtë qëllim ka vijuar gjykimin të cilin e ka përfunduar më datë 25.02.2015, jashtë afatit 22 ditore.

Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, duke iu referuar çështjeve të analizuara më sipër në të cilat për 4 (katër) prej tyre parashikohet afat ligjor për përfundimin e tyre dhe nga këto vetëm 1 (një) çështje ka përfunduar jashtë afatit ligjor (22 ditë), rezulton se raporti i çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjor në raport me numrin e përgjithshëm të çështjeve për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është 25 %.

⁶² Neni 16 i Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar -Gjykimi për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes - parashikon se : “I. Gjykata vendos për shqyrtimin e kërkesës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes brenda 15 ditëve pas pranimit të kërkesës”.

⁶³ Neni 18 i Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” - Gjykimi për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes - parashikon se : “I. Gjykata vendos në lidhje me kërkesën për mbrojtje të menjëhershme brenda 48 orëve pas parashtrimit të kërkesës”.

⁶⁴ Po aty, neni 19, pika 3, shkronja d -Vendimi i gjykatës për lëshimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes-parashikon se : “3... d) datën e dëgjimit për vërtetimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, e cila është brenda 20 ditëve prej lëshimit të tij me vendim gjykate”.

Rezultoi se 1 çështje të shqyrtuar tej afatit ligjor, gjyqtarja ka shqyrtuar kërkesën për lëshim urdhëri të menjëhershëm të mbrojtjes brenda afatit 48 orë të shqyrtimit të saj.

Referuar tabelës së pikëzimit për këtë tregues, të përcaktuar në rregulloren nr.264/2019 “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, kjo përqindje ekuivalentohen me 9 pikë (21-30 - 9 pikë).

Në metodologjinë e pikëzimit, lidhur me këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjithave burimeve të vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si: kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit të punës, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së tij, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

Për sa i përket çështjes së mësipërme të shqyrtuar jashtë afatit, me objekt lëshim urdhër i menjëhershëm i mbrojtjes, rezulton se gjyqtari e ka shqyrtuar kërkesën për lëshim urdhëri të menjëhershëm të mbrojtjes brenda afatit 48 orë, ndërsa padia për vërtetimin e këtij urdhëri është shqyrtuar tej afatit ligjor prej 20 ditësh, për shkaqe procedurale, që lidhet me njoftimin dhe marrjen e provës me dëshmitar.

Në lidhje me aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, rezulton se gjyqtari ka përfunduar në total për gjithë periudhën 3-vjeçare objekt vlerësimi (08.10.2013- 08.10.2016) 1479 çështje gjyqësore, nga të cilat 1303 çështje civile (325 civile themeli, 467 familjare, 511 kërkesa civile) dhe 176 çështje penale (1 penale themeli 175 penale masa sigurimi), pra rreth 793 çështje themeli për periudhën 3 vjeçare, mesatarisht 264.3 çështje themeli në vit, ndërkohë që duhej të shqyrtonte jo më pak se 120 çështje themeli në vit në rast se ka gjykuar në seksonin civil dhe 200 çështje nëse ka gjykuar në seksionin familjare, referuar vendimit 261/2 të ish KLD-së⁶⁵ duke tejkaluar këtë standard me 65% .

Duke konsideruar natyrën e kërkesave të shqyrtuara tej afatit ligjor, të cilat janë të lehta, si dhe duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vendimi me objekt vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi personal, që nga ana e gjyqtarit është respektuar afati ligjor i shqyrtimit, prezumimin se edhe për 173 çështje të tjera që i përkasin kësaj kategorie “masa sigurim personal”, gjyqtari ka respektuar gjithmonë afatin ligjor të shqyrtimit të tyre, por edhe të kërkesave të tjera me objekt sigurim padie që mund të jenë paraqitur gjatë gjykimeve, vlerësohet se gjyqtari merr masa për shqyrtimin e çështjeve brenda afateve ligjore.

⁶⁵Lidhur me standardin sasior të punës, në vendimin nr. 261/2, viti 2010 të KLD-së parashikohet standardi sasior si më poshtë:... d. Gjyqtari i shkallës së parë i dhomës civile, si relator, i seksionit familjar, jo me pak se 200 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje familjare. e. Gjyqtari i shkallës së parë i dhomës civile, si relator, i seksionit të përgjithshëm, jo me pak se 120 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtare

KONKLUZIONE

Në tërësi, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me: (i) raportin e çështjeve dhe kërkesave të gjykuara në tejkalim të afatit ligjor, që rezultojnë në masën 25 %; (ii) faktin kërkesa/ padia që është shqyrtuar tej afatit ligjor prej 22 ditëve është me objekt lëshim urdhër i menjëhershëm të mbrojtjes, dhe gjyqtari e ka lëshuar këtë urdhër brenda afatit 48 orë, (iii) ngarkesën e gjyqtari si relator gjatë periudhës së vlerësimit (në total ka gjykuar 1479 çështje, duke gjykuar mesatarisht 493 çështje në vit, nga të cilat rreth 264.3 çështje janë me palë kundërshtare dhe gjatë kësaj periudhe së paku janë shqyrtuar 175 çështje (masa sigurim) të cilat janë me afat ligjor), gjyqtari për këte tregues duhet të vlerësohet në nivelin maksimal të tij, duke e pikëzuar me 15 pikë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Respektimi i afateve ligjore” gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 15 pikë, duke e vlerësuar se përqindja e çështjeve të gjykuara prej tij tej afatit ligjor është 0-10 %.*

2.A.B. Plotësimi i standardeve minimale kohore

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short);

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve konkludohet si më sipër, cituar në treguesin 2.A.A “Respektimi i afateve ligjore”.

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues, do të bëhet duke

iu referuar 9⁶⁶ (nëntë) çështjeve të përzgjedhura me short dhe 1 (një) vendimi të zgjedhur nga gjyqtari.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, evidentohet se për çështjet e vëzhguara, gjykimi ka zgjatur përgjithësisht brenda standardeve minimale kohore, ku referuar parashikimeve të vendimit nr. 261/2, datë 14.04.2010 të ish KLD-së (të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve), duke i ndarë sipas kategorisë së çështjeve, rezulton:

Çështje civile të përgjithshme :

- **Dosja 1** - Çështja civile nr. 7977 regjistri, datë regjistrimi 07.04.2016, që i përket palëve ndërgjyqëse : palë paditëse A&K Murataj sh.p.k., palë e paditur S. Konstruksion sh.p.k., me objekt detyrimin e palës së paditur për pagim shume etj, **përfunduar me vendimin nr. 6862, datë 08.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë** (çështja është caktuar me short më datë 07.04.2016 dhe ka përfunduar më datë 08.09.2016). Gjykimi ka zgjatur 5 muaj e 1 ditë, **brenda afatit** 6 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet civile, të përcaktuar në pikën 5, gërma “e”, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve;
- **Dosja 2** - Çështja civile nr. 8028 regjistri, datë regjistrimi 30.04.2015, që i përket palëve ndërgjyqëse : palë paditëse AKEP, palë e paditur Ada Holding - Ada Air sh.p.k.etj., me objekt detyrimin e palëve të paditura të paguajnë faturat e lëshuara, si detyrime të papaguara nga shërbimi telefonik fiks, **përfunduar me vendimin nr. 5785, datë 10.07.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë** (çështja është caktuar me short më datë 07.05.2015 dhe ka përfunduar më datë 10.07.2015). Gjykimi ka zgjatur 2 muaj e 3 ditë, **brenda afatit** 6 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet civile, të përcaktuar në pikën 5, gërma “e”, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve;
- **Dosja 8 (3)** - Çështja civile nr. 9811 regjistri, datë regjistrimi 23.06.2015, që i përket palëve ndërgjyqëse : palë paditëse S.B., palë e paditur “Lapsi.AL” sh.p.k., me objekt detyrimin për ndalimin e publikimeve dhe heqjen e materialeve të publikuara etj., **përfunduar me vendimin nr. 7756, datë 15.10.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë** (çështja është caktuar me short më datë 25.06.2015 dhe ka përfunduar më datë 15.10.2015). Gjykimi ka zgjatur 3 muaj e 22 ditë, **brenda afatit** 6 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet civile, të përcaktuar në pikën 5, gërma “e”, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve;
- **Dosja 10 (5)** - Çështja civile nr. 5005 regjistri, datë regjistrimi 15.01.2016, që i përket palëve ndërgjyqëse : palë paditëse Albtelekom sh.a., palë e paditur A.Gj., me objekt pagim shume, **përfunduar me vendimin nr. 3004, datë 12.04.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë** (çështja është caktuar me short më datë 18.01.2016 dhe ka përfunduar më datë 12.04.2016). Gjykimi ka zgjatur 2 muaj e 24 ditë, **brenda afatit** 6 muajor të standardit minimal kohor për

⁶⁶ Nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi, konkretisht vendimet gjyqësore nr. 2510 akti, datë 08.10.2016; nr. 1951, datë 11.02.2014; nr. 2634 akti, datë 20.10.2016; nr. 1411, datë 25.02.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

gjykimet civile, të përcaktuar në pikën 5, gërma “e”, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve;

- **Dosja 11 (6)** - Çështja civile nr. 14286/3844 regjistri, datë regjistrimi 24.11.2015, që i përket palëve ndërgjyqëse : palë paditëse Albtelekom sh.a., palë e paditur F.V., me objekt pagim shume, **përfunduar me vendimin nr. 2092, datë 15.03.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë** (çështja është caktuar me short më datë 26.11.2015 dhe ka përfunduar më datë 15.03.2016). Gjykimi ka zgjatur 3 muaj e 19 ditë, **brenda afatit** 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile, të përcaktuar në pikën 5, gërma “e”, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve;

Çështje civile familjare :

- **Dosja 4** - Çështja civile nr. 4851 regjistri, datë regjistrimi 20.01.2015, që i përket palëve ndërgjyqëse : palë paditëse Sh.N., palë e paditur H.N., me objekt zgjidhje martese, **përfunduar me vendimin nr. 1533, datë 02.03.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë** (çështja është caktuar me short më datë 21.01.2015 dhe ka përfunduar më datë 02.03.2015). Gjykimi ka zgjatur 1 muaj e 9 ditë, **brenda afatit** 4 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile, të përcaktuar në pikën 5, gërma “d”, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve;
- **Dosja 6 (1)** - Çështja civile nr. 9338 regjistri, datë regjistrimi 20.03.2014, që i përket palëve ndërgjyqëse : palë paditëse A.P., palë e paditur L.P., me objekt zgjidhje martese dhe të pasojave ligjore që rrjedhin prej saj, **përfunduar me vendimin nr. 5408, datë 02.05.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë** (çështja është caktuar me short më datë 21.03.2014 dhe ka përfunduar më datë 02.05.2014). Gjykimi ka zgjatur 1 muaj e 11 ditë, **brenda afatit** 4 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile, të përcaktuar në pikën 5, gërma “d”, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve;
- **Vendimi 2 - Vendimi gjyqësor civil nr. 10036, datë 20.10.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë**, dhënë në përfundim të shqyrtimit të çështjes civile që i përket palëve ndërgjyqëse : palë paditëse V.M., kundër palës së paditur J.M., me objekt zgjidhje martese ligjore. Sipas të dhënave nga përmbajtja e vendimit të arsyetuar rezulton se çështja është regjistruar më datë 19.05.2014 dhe ka përfunduar më datë 20.10.2014). Gjykimi ka zgjatur 5 muaj, **pra jashtë afatit** 4 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile, të përcaktuar në pikën 5, gërma “d”, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve. Megjithatë po të zbresim në kohëzgjatjen e çështjes, kohën e kryerjes së pushimeve vjetore të kryera në muajin gusht, çështja rezulton e përfunduar **për rreth 4 muaj, pra brenda standardit** minimal kohor prej 4 (katër) muaj të parashikuar në pikën 5, gërma “d” të vendimit nr. 261/2 të KLD.

Çështje civile pa palë kundërshtare :

- **Dosja 3** - Çështja civile nr. 8724 regjistri, datë regjistrimi 26.02.2014, që i përket palëve ndërgjyqëse : palë kërkuese I.I dhe B.I., me objekt lëshim autorizimi për tjetërsim pasurie,

përfunduar me vendimin nr. 3581, datë 18.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (çështja është caktuar me short më datë 27.02.2014 dhe ka përfunduar më datë 18.03.2014). Gjykimi ka zgjatur 19 ditë, **brenda afatit** 2 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet civile pa palë kundërshtare, referuar përcaktimeve të Vendimit për Sistemin e Vlerësimit të Gjyqtarëve.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga 10 (dhjetë) çështjet për të cilat zbatohen standardet minimale kohore, sikundër rezultoi edhe më sipër, rezultoi se të gjitha çështjet kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor, sipas përcaktimeve të Vendimit për Sistemin e Vlerësimit të Gjyqtarëve të ish KLD-së. Sipas “*Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit*”, të miratuar me vendimin me Nr. 264, datë 21.11.2019 të KLGJ, përqindja matematikore prej 0 % përkon me nivelin e vlerësimit 5 (pesë) pikë (0-10% - 5 pikë).

KONKLuzioni

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar vetëm analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit (10 çështje) me numrin total të çështjeve për të cilat zbatohet standardi (0 çështje) që rezulton 0 % , vlerësohet se për këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet në nivelin maksimal.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Plotësimi i standardeve minimale kohore” gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë, pasi përqindja e çështjeve të shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor prej 0 %, është brenda marzhi 0-10%.

2.A.C. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve konkludohet si më sipër, cituar në treguesin 2.A.A “*Respektimi i afateve ligjore*”.

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 9 (nëntë) çështjeve të përzgjedhura me short, 1 (një) vendimi të përzgjedhur nga gjyqtari, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor dhe jo afati ligjor i gjykimit⁶⁷.

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, në raport me standardin minimal kohor në fuqi, sipas përcaktimeve të Vendimit për Sistemin e Vlerësimit të Gjyqtarëve të ish KLD-së, për secilën kategori (pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi), është si më poshtë:

- (i) Në kategorinë e çështjeve “*Civile të përgjithshme me palë kundërshtare*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është rreth 109 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muajsh.
- (ii) Në kategorinë e çështjeve “*Civile marrëdhënie familjare*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është rreth 77 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 4 muajsh.
Theksojmë këtu se në përlogaritjen e afateve të njërës prej çështjeve përfshihet dhe periudha e muajit gusht të pushimeve vjetore, prej 30 ditë e detajuar më lart.
- (iii) Në kategorinë e çështjeve “*Civile pa palë kundërshtare*”, që është vetëm një e tillë, koha mesatare që i dedikohet kësaj çështje është 19 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar prej 2 muajsh.

Pra, kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara, është më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve. Referuar metodologjisë së Pikëzimit, kjo llogaritje matematikore përkon me pikëzim prej 5 pikësh

KONKLUZIONI

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, duke qenë se rezultoi se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër se standardi minimal për të gjitha kategoritë e çështjeve të vlerësuar, gjyqtari duhet të pikëzohet në nivelin maksimal për këtë tregues.

⁶⁷ Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se: “*Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi*”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është më e shkurtër se standardin minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve dhe për këtë arsye gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.

2.A.Ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me rendimentin e përfundimit të çështjeve konkludohet se: *“Subjekti i rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013-08.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, njëkohësisht në dhomën civile dhe atë penale. Ai ka deklaruar se gjatë tre viteve të fundit i janë caktuar për gjykim gjithsej 1890 çështje, ku ka përfunduar 1675 çështje, duke mbartur vitin e fundit 96 çështje. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna është 88.6 %.*

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013-08.10.2016 gjyqtari Adriatik Bocaj, ka përfunduar 1479 çështje gjyqësore, nga të cilat 1303 çështje civile (325 civile themeli, 467 familjare, 511 kërkesa civile) dhe 176 çështje penale (1 penale themeli 175 penale masa sigurimi).

Sipas pikës 3, shkronja a, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, që nuk është i organizuar në seksione, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 200 çështje penale dhe civile që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje me palë kundërshtare. Sipas të dhënave statistikore, konstatohet se ngarkesa sasimore e gjyqtarit Adriatik Bocaj, ka qenë mbi standardin minimal”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për efekte të organizimit të shortit, ka rezultuar se për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013-08.10.2016 gjyqtari Adriatik Bocaj, ka përfunduar 1479 çështje gjyqësore, nga të cilat 1303 çështje civile (325 civile themeli, 467 familjare, 511 kërkesa civile) dhe 176 çështje penale (1 penale themeli 175 penale masa sigurimi).

Pra, rezultoi se gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtari ka përfunduar në total për 3 vitet e periudhës së vlerësimit 1479 çështje, nga të cilat 793 çështje (325 civile themeli, 467

familjare, 1 penale themeli), ku mesatarisht i bie 264 çështje themeli në vit, duke tejkaluar kështu standardin sasior që është 200 çështje themeli në vit.

Referuar këtyre të dhënave statistikore⁶⁸, rezultoi se gjyqtari Adriatik Bocaj për gjithë periudhën e vlerësimit 01.01.2014- 08.10.2016, ka shqyrtuar këto çështje, të ndarë për çdo vit kalendarik:

Për vitin 2014 : i janë caktuar për gjykim 560 çështje dhe ka përfunduar 505 çështje, duke mbartur 55 çështje. Rendimenti është 90.17 %.

Për vitin 2015 : i janë caktuar për gjykim 550 çështje dhe ka përfunduar 486 çështje, duke mbartur 64 çështje civile. Rendimenti është 88.36 %.

Për vitin 2016 : i janë caktuar për gjykim 554 çështje dhe ka përfunduar 458 çështje, duke mbartur 96 çështje. Rendimenti është 82.67 %.

Në total, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, duke e marrë të plotë vitin 2016 (duke qenë se nuk kemi informacion sa çështje i janë caktuar gjyqtarit për periudhat tetor – dhjetor 2013 dhe janar-tetor 2016) gjyqtarit i janë caktuar për gjykim 1664 çështje dhe ka përfunduar 1449 çështje⁶⁹, ose 87.08 %. Nga llogaritja e numrit të çështjeve të caktuara me numrin e çështjeve të përfunduara me vendim, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve gjatë kësaj periudhe është 87.08 %. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, ky rendiment pikëzohet me 6 pikë (Mbi 87-93%- 6 pikë).

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: *“Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50 % të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli.”*

Në lidhje me aspektin sasior të volumit të çështjeve, referuar pikës 3, shkronja “e” të vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD (Aneksit 1), gjyqtari i dhomës civile të seksionit të përgjithshëm duhet të gjykojë jo më pak se 120 çështje me palë kundërshtare në një vit, i llogaritur në periudhën 3 vjeçare jo me pak se 360 çështje civile. Ndërsa gjyqtari i dhomës civile, që ka gjykuar në seksionin familjar, ashtu siç ka gjykuar edhe gjyqtari në rastin konkret, duhet të gjykojë jo më pak se 200 çështje, që ka të bëjë me mosmarrëveshje familjar

⁶⁸ Faqe 22 e Raportit për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

⁶⁹ Gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit tetor 2013-tetor 2016 ka përfunduar 1479 çështje, por për të përlllogaritur rendimentin (për shkak sepse nuk kemi informacion të plotë sa çështje i janë caktuar gjyqtarit këtë periudhë, por dimë vetëm sa ka përfunduar) do të marrim 3 vitet e plota.

në një vit, i llogaritur në periudhën 3 vjeçare jo me pak se 600 çështje, që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje familjare.

Ndërsa në pikën 3, shkronja “ë” të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve, të miratuar me vendimin nr.261/2, datë 14.04.2010 të KLD, përcaktohet se; *Standardi sasior i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari brenda një viti kalendarik të një ngarkesë pune minimale si më poshtë; ë. Gjyqtari i shkallës së parë, i dhomës civile e penale, shqyrton jo më pak se 400 çështje të natyrës kërkesa (civile ose penale) me ose pa palë të interesuara”.*

Gjatë periudhës 3 vjeçare të vlerësimit gjyqtari ka gjykuar si në seksionin civil ashtu dhe në seksionin familjar, duke përfunduar se gjykuara edhe çështjet civile të shortuara më para. Gjatë periudhës së vlerësimit ai ka përfunduar 1479 çështje gjyqësore, nga të cilat 1303 çështje civile e familjare (325 civile themeli, 467 familjare, 511 kërkesa civile) dhe 176 çështje penale (1 penale themeli 175 penale masa sigurimi), pra ka përfunduar 792 çështje civile e familjare themeli, duke tejkuluar kështu standardin sasior prej 600 çështje me palë kundërshtare, me rreth 192 çështje (792-600) apo me 32 % për periudhën tre vjeçare të vlerësimit. Sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.04.2010, neni 3 pika “e”, gjyqtari në tre vite vlerësimi duhet të gjykonte jo më pak se 600 çështje që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje familjare, ndërkohë siç u theksua edhe më lart, gjyqtari ka edhe në seksionin civil si dhe ka vijuar të përfundoj të gjitha çështjet civile të caktuara në parë, përpara se të caktohej në seksionin familjar, duke përfunduar gati 325 çështje civile, çka është afër standardit minimal sasior prej 360 çështje themeli në vit, në rast se ai do të kishte gjykuar vetën me seksionin civil të përgjithshme. Sa më sipër, referuar numrit të çështjeve të përfunduara, vlerësohet se ai e ka tejkuluar standardin sasior me mbi 50 %, konkretisht me 64 %

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, megjithëse rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit sipas raportit për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar të hartuar nga KLGJ është llogaritur 88.6 %, ndërsa sipas të dhënave statistikore rezulton në masën e 87.08 %, përqindje e cila referuar metodologjisë së Pikëzimit pikëzohet me 6 pikë, pasur parasysh faktin se gjyqtari e ka tejkuluar në çdo vit standardin minimal të miratuar, me më shumë se 50 %, numrin e lartë të kërkesave penale e civile të shqyrtuara gjatë periudhës së vlerësimit prej 687 kërkesa, të cilat rrisin dukshëm ngarkesën e gjyqtarit (pasur parasysh se disa kanë qenë edhe me afat ligjor, psh urdhërat e ekzekutimit, apo masat e sigurimit personal), vlerësohet se mund të arrihet në një pikëzim më të lartë se ai që i përket rendimentit të gjyqtarit, duke u pikëzuar me 10 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 10 pikë, duke qenë se në çdo vit e ka tejkaluar standatim minimal sasior me mbi 50%.

s2.A.D. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit, deri në datën e depozitimit në kryesekretari të vendimit të arsyetuar. Për periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues, në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short);
- Informacioni i përcjellë nga gjykata lidhur me afatin e dorëzimit të vendimeve të arsyetuara.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se : *“Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara, është konstatuar se gjyqtari Adriatik Bocaj, ka respektuar afatin ligjor të dorëzimit të vendimit në të pesë rastet që i përkasin dosjeve 1,2,3, 4 dhe 5. Konkretisht, arsyetimi i vendimeve është kryer për 2 ditë nga shpallja (shih dosjen 1), për 4 ditë nga shpallja (shih dosjet 2 e 4); për 1 ditë nga shpallja (shih dosjet 3 e 5)”*.

Referuar parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile, para ndryshimeve me Ligjin 38/2017, afati i dorëzimit të vendimit të arsyetuar në sekretari ishte parashikuar 10 ditë (neni 308/2), me përjashtim të rastit kur gjykata vlerësonte shtyrjen e shpalljes së arsyetuar të vendimit me 5 ditë. Në këto kushte, në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet

parasysh në rastin konkret, afati 10 ditor i ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Dosjet e përzgjedhura me short, të administruara gjatë procesit të rivlerësimit⁷⁰, janë dorëzuar të arsyetuara, si më poshtë :

Dosja 1 - Çështja civile nr. 7977 regjistri, datë regjistrimi 07.04.2016, që i përket palëve ndërgjyqëse : palë paditëse A&K Murataj sh.p.k., palë e paditur S. Konstruksion sh.p.k., me objekt detyrimin e palës së paditur për pagim shume etj., **përfunduar me vendimin nr. 6862, datë 08.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë**, është dorëzuar e arsyetuar më datë 13.09.2016 - (pas 5 ditësh), **brenda** afatit 10 ditorë të parashikuar në nenin 308 të K.Pr.Civile, në fuqi në këtë kohë;

Dosja 2 - Çështja civile nr. 8028 regjistri, datë regjistrimi 30.04.2015, që i përket palëve ndërgjyqëse : palë paditëse AKEP, palë e paditur Ada Holding - Ada Air sh.p.k.etj., me objekt detyrimin e palëve të paditura të paguajnë faturat e lëshuara, si detyrime të papaguara nga shërbimi telefonik fiks, **përfunduar me vendimin nr. 5785, datë 10.07.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë**, është dorëzuar e arsyetuar më datë 14.07.2015 - (pas 4 ditësh), **brenda** afatit 10 ditorë të parashikuar në nenin 308 të K.Pr.Civile, në fuqi në këtë kohë;

Dosja 3 - Çështja civile nr. 8724 regjistri, datë regjistrimi 26.02.2014, që i përket palëve ndërgjyqëse : palë kërkuese I.I dhe B.I., me objekt lëshim autorizimi për tjetërsim pasurie, **përfunduar me vendimin nr. 3581, datë 18.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë**, është dorëzuar e arsyetuar më datë 20.03.2014 - (pas 2 ditësh), **brenda** afatit 10 ditorë të parashikuar në nenin 308 të K.Pr.Civile, në fuqi në këtë kohë;

Dosja 4 - Çështja civile nr. 4851 regjistri, datë regjistrimi 20.01.2015, që i përket palëve ndërgjyqëse : palë paditëse Sh.N., palë e paditur H.N., me objekt zgjidhje martesë, **përfunduar me vendimin nr. 1533, datë 02.03.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë**, është dorëzuar e arsyetuar më datë 04.03.2016 - (pas 2 ditësh), **brenda** afatit 10 ditorë të parashikuar në nenin 308 të K.Pr.Civile, në fuqi në këtë kohë;

Dosja 5 - Çështja/kërkesa penale nr. 2510 regjistri, datë regjistrimi 07.10.2016, që i përket palës kërkuese Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë të shtetasit S.Q. dhe caktimin e masës së sigurimit personal ndaj tij “arrest në burg”, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a/1 i K.Penal, **përfunduar me vendimin nr. 2510 akti, datë 08.10.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë**, është dorëzuar e arsyetuar më datë 10.10.2016 - (pas

⁷⁰ Sipas Raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit

2 ditësh), brenda afatit ligjor 5 ditor të përcaktuar nga neni 113 i K.Pr.Penale, në fuqi në këtë kohë.

Ndërsa 6 (gjashtë) dosjet e përzgjedhura me short, për efekt të këtij procesi vlerësimi (gradim), sipas informacioneve të dërguara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, janë dorëzuar të arsyetuara, si më poshtë :

Dosja 6 (1) - Çështja civile nr. 9338 regjistri, datë regjistrimi 20.03.2014, që i përket palëve ndërgjyqëse : palë paditëse A.P., palë e paditur L.P., me objekt zgjidhje martese dhe të pasojave ligjore që rrjedhin prej saj, **përfunduar me vendimin nr. 5408, datë 02.05.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë**, është dorëzuar e arsyetuar më datë 07.05.2014 - (pas 5 ditësh), **brenda** afatit 10 ditorë të parashikuar në nenin 308 të K.Pr.Civile, në fuqi në këtë kohë;

Dosja 7 (2) - Çështja civile nr. 8147 regjistri, datë regjistrimi 06.02.2014, që i përket palëve ndërgjyqëse : palë paditëse F.D., palë e paditur I.M., me objekt zgjidhje martese, **përfunduar me vendimin nr. 4919, datë 17.04.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë**, është dorëzuar e arsyetuar më datë 22.04.2014 - (pas 5 ditësh), **brenda** afatit 10 ditorë të parashikuar në nenin 308 të K.Pr.Civile, në fuqi në këtë kohë;

Dosja 8 (3) - Çështja civile nr. 9811 regjistri, datë regjistrimi 23.06.2015, që i përket palëve ndërgjyqëse : palë paditëse S.B., palë e paditur “Lapsi.AI” sh.p.k., me objekt detyrimin për ndalimin e publikimeve dhe heqjen e materialeve të publikuara etj., **përfunduar me vendimin nr. 7756, datë 15.10.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë**, është dorëzuar e arsyetuar më datë 20.10.2015 - (pas 5 ditësh), **brenda** afatit 10 ditorë të parashikuar në nenin 308 të K.Pr.Civile, në fuqi në këtë kohë;

Dosja 9 (4) - Çështja civile nr. 5067 regjistri, datë regjistrimi 27.01.2015, që i përket palëve ndërgjyqëse : palë paditëse M.L., palë e paditur L.K., me objekt lëshim urdhri i menjëhershëm mbrojtje, **përfunduar me vendimin nr. 1411, datë 25.02.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë**, është dorëzuar e arsyetuar më datë 27.02.2015 - (pas 2 ditësh), jashtë afatit 24 orë e parashikuar nga ligji nr.9669/2006,« Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare«, në fuqi në këtë kohë duke e tejkalluar këtë afat me 1 ditë, tejkallim i cili vlerësohet i papërfillshëm;

Dosja 10 (5) - Çështja civile nr. 5005 regjistri, datë regjistrimi 15.01.2016, që i përket palëve ndërgjyqëse : palë paditëse Albtelekom sh.a., palë e paditur A.Gj., me objekt pagim shume, **përfunduar me vendimin nr. 3004, datë 12.04.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë**, është dorëzuar e arsyetuar më datë 14.04.2016 - (pas 2 ditësh), **brenda** afatit 10 ditorë të parashikuar në nenin 308 të K.Pr.Civile, në fuqi në këtë kohë;

Dosja 11 (6) - Çështja civile nr. 14286/3844 regjistri, datë regjistrimi 24.11.2015, që i përket palëve ndërgjyqëse : palë paditëse Albtelekom sh.a., palë e paditur F.V., me objekt pagim shume, përfunduar me vendimin nr. 2092, datë 15.03.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është dorëzuar e arsyetuar më datë 18.03.2016 - (pas 3 ditësh), brenda afatit 10 ditorë të parashikuar në nenin 308 të K.Pr.Civile, në fuqi në këtë kohë;

Duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt shqyrtimi, rezulton se koha mesatare e arsytimit të vendimit për çështjet e kategorisë “Civile themeli” është 3.8 ditë, brenda afatit 10 ditorë të parashikuar nga neni 308 i K.Pr.Civile në atë kohë; për kategorinë e çështjeve “Familjare me palë kundërshtarë” është 4 ditë, brenda afatit 10 ditorë të parashikuar nga neni 308 i K.Pr.Civile në fuqi në atë kohë, për kategorinë “Urdhër mbrojtje/ urdhër i menjëhershëm mbrojtje” është 2 ditë, jashtë afatit 24 orë i parashikuar në ligjin nr.9669/2006 i ndryshuar, por duke e tejkalluar këtë afat vetëm me 1 ditë, tejkallim i cili vlerësohet i papërfillshëm dhe për kategorinë e çështjeve “Kërkesa penale” është 2 ditë, brenda afatit 5 ditorë.

Për sa më sipër, rezulton se koha mesatare e arsytimit të vendimit është më e shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve. Sipas Metodologjisë Pikëzimit kjo llogaritje pikëzohet me 15 pikë.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar klasifikohet si “*Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve*” dhe gjyqtari duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: *Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Koha mesatare e arsytimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” vlerësohet se koha mesatare e arsytimit të vendimit është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, e për këtë arsye gjyqtari pikëzohet me 15 pikë.*

2.B. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE

2.B.A. Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues, në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;

- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “*Subjekti i rivlerësimit Adriatik Bocaj ka aftësi në planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Në 4 çështjet civile të vëzhguara, ai ka kryer gjithnjë veprimet përgatitore (shih dosjet 1-4). Në këto 4 raste, veprimet përgatitore kanë qenë efektive, i kanë shërbyer ecurisë pa vonesa të gjykimit dhe janë dokumentuar gjithmonë me proces verbal të rregullt nga pikëpamja formale.*

Në 4 çështje civile, gjykimet kanë përfunduar me 2-7 seanca. Ndërsa çështja administrative penale e vëzhguar, që lidhet me kërkesën për vleftësim të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal ka përfunduar me 1 seancë (shih dosjen 5).

Konkretisht janë vëzhguar 18 seanca gjyqësore, nga të cilat 14 kanë qenë produktive. Pengesë në 4 seanca joproduktive kanë qenë : mosparaqitja e palëve ndërgjyqëse (1 seancë), caktimi i seancës në ditë feste zyrtare (1 seancë), mosparaqitja e palës së paditur (1 seancë) dhe mosformimi i trupit gjykues (1 seancë).

Gjatë gjykimit, subjekti i rivlerësimit identifikon veprimet procedural që duhen kryer dhe nxjerr urdhra e vendime të ndërmjetme për realizimin e tyre. Zhvillon sipas ligjit procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, që nga çelja e seancës, tek pretendimet fillestare të palëve, administrimi i provave, diskutimet përfundimtare të palëve e gjer tek shpallja e vendimit.

Në gjykimin e kërkesës administrative penale, data për seancën e parë është caktuar menjëherë pas paraqitjes së kërkesës, siç është parashikuar nga neni 258 i K.Pr.Penale, por konstatohet në proces verbal mungesa e pasqyrimin të orës së çeljes së seancës gjyqësore, në shkëlq të kërkesave të nenit 345/1/a të K.Pr.Penale (shih dosjen 5)”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se :

Nga 11 (njëmbëdhjetë) çështjet e përzgjedhura për vlerësim, lidhur me numrin e seancave gjyqësore, 9 (nëntë) prej tyre vlerësohen si çështje me palë kundërshtare, për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, pasi dosja nr. 3⁷¹ i takon kategorisë çështje civile

⁷¹ Dosja që i përket çështjes civile nr. 8724 regjistri, datë regjistrimi 26.02.2014, që i përket palëve ndërgjyqëse: palë kërkuese I.I dhe B.I., me objekt lëshim autorizimi për tjetërsim pasurie, përfunduar me vendimin nr. 3581, datë 18.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

pa palë kundërshtare dhe dosja nr. 5⁷², i takon kategorisë kërkesa penale në fazën e hetimeve paraprake.

Në çështjet e përzgjedhura me short, të administruara në dosjen e rivlerësimit konstatohet se:

Dosja 1 - Çështja civile nr. 7977 regjistri, datë regjistrimi 07.04.2016, që i përket palëve ndërgjyqëse : palë paditëse A&K Murataj sh.p.k., palë e paditur S. Konstruktion sh.p.k., me objekt detyrimin e palës së paditur për pagim shume etj., **përfunduar me vendimin nr. 6862, datë 08.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë**, rezulton të jenë planifikuar 5 seanca gjyqësore, por në fakt janë zhvilluar 4 (katër) seanca gjyqësore, për shkak se një datë prej tyre ka përkuar me një ndër festat zyrtare.

Dosja 2 - Çështja civile nr. 8028 regjistri, datë regjistrimi 30.04.2015, që i përket palëve ndërgjyqëse : palë paditëse AKEP, palë e paditur Ada Holding - Ada Air sh.p.k.etj., me objekt detyrimin e palëve të paditura të paguajnë faturat e lëshuara, si detyrime të papaguara nga shërbimi telefonik fiks, **përfunduar me vendimin nr. 5785, datë 10.07.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë**, rezulton të jenë zhvilluar 2 (dy) seanca gjyqësore.

Dosja 4 - Çështja civile nr. 4851 regjistri, datë regjistrimi 20.01.2015, që i përket palëve ndërgjyqëse : palë paditëse Sh.N., palë e paditur H.N., me objekt zgjidhje martese, **përfunduar me vendimin nr. 1533, datë 02.03.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë**, rezulton të jetë zhvilluar 1 (një) seancë gjyqësore.

Në çështjet e përzgjedhura me short, pas fillimit të procedurës së vlerësimit konstatohet se:

Dosja 6 (1) - Çështja civile nr. 9338 regjistri, datë regjistrimi 20.03.2014, që i përket palëve ndërgjyqëse : palë paditëse A.P., palë e paditur L.P., me objekt zgjidhje martese dhe të pasojave ligjore që rrjedhin prej saj, **përfunduar me vendimin nr. 5408, datë 02.05.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë**, rezulton të jenë zhvilluar 2 (dy) seanca gjyqësore.

Dosja 7 (2) - Çështja civile nr. 8147 regjistri, datë regjistrimi 06.02.2014, që i përket palëve ndërgjyqëse : palë paditëse F.D., palë e paditur I.M., me objekt zgjidhje martese, **përfunduar me vendimin nr. 4919, datë 17.04.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë**, rezulton të jetë zhvilluar 1 (një) seancë gjyqësore.

Dosja 8 (3) - Çështja civile nr. 9811 regjistri, datë regjistrimi 23.06.2015, që i përket palëve ndërgjyqëse : palë paditëse S.B., palë e paditur “Lapsi.AI” sh.p.k., me objekt detyrimin për ndalimin e publikimeve dhe heqjen e materialeve të publikuara etj., **përfunduar me**

⁷² Dosja që i përket çështjes/kërkesa penale nr. 2510 regjistri, datë regjistrimi 07.10.2016, që i përket palës kërkuese Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë të shtetasit S.Q. dhe caktimin e masës së sigurimit personal ndaj tij “arrest në burg”, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a/1 i K.Penal, përfunduar me vendimin nr. 2510 akti, datë 08.10.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

vendimin nr. 7756, datë 15.10.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton të jenë zhvilluar 2 (dy) seanca gjyqësore.

Dosja 9 (4) - Çështja civile nr. 5067 regjistri, datë regjistrimi 27.01.2015, që i përket palëve ndërgjyqëse : palë paditëse M.L., palë e paditur L.K., me objekt lëshim urdhri i menjëhershëm mbrojtje, **përfunduar me vendimin nr. 1411, datë 25.02.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë**, rezulton të jenë zhvilluar 5 (pesë) seanca gjyqësore, ku njëra prej tyre është seanca për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes (brenda 48 orëve nga paraqitja e kërkesë padisë) ndërsa 4 seanca janë zhvilluar gjatë shqyrtimit të verifikimit të urdhrin të mbrojtjes, ku janë marrë prova me dëshmitarë të kërkuar nga të dyja palët ndërgjyqëse, si dhe i është kohë palës së paditur të përfaqësohet me avokat.

Dosja 10 (5) - Çështja civile nr. 5005 regjistri, datë regjistrimi 15.01.2016, që i përket palëve ndërgjyqëse : palë paditëse Albtelekom sh.a., palë e paditur A.Gj., me objekt pagim shume, **përfunduar me vendimin nr. 3004, datë 12.04.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë**, rezulton të jetë zhvilluar 1 (një) seancë gjyqësore.

Dosja 11 (6) - Çështja civile nr. 14286/3844 regjistri, datë regjistrimi 24.11.2015, që i përket palëve ndërgjyqëse : palë paditëse Albtelekom sh.a., palë e paditur F.V., me objekt pagim shume, **përfunduar me vendimin nr. 2092, datë 15.03.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë**, rezulton të jenë zhvilluar 3 (tre) seanca gjyqësore.

Nga tërësia e të dhënave siç parashtrihen më sipër, rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtari në 9 çështjet e vëzhguara me palë kundërshtare (civile themeli) varion nga 1 deri në 5 seanca.

Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 2.3 seanca gjyqësore në çështjet civile me palë kundërshtare (duke përjashtuar seancat përgatitore/të pajtimit).

Nga vëzhgimi i 9 dosjeve të çështjeve të përzgjedhura (çështje civile themeli dhe familjare) me short për vlerësim, rezulton se gjyqtari ka kryer përgjithësisht me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore duke respektuar në çdo rast ligjin procedural civil dhe penal. Nga gjyqtari në pjesën më të madhe të rasteve janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë, përveç disa rasteve kur gjyqtari nuk ka marrë në konsideratë në caktimin e datës së zhvillimit të seancës, afatin që nevojitet për njoftimin e palëve me shpallje, duke shtyre në disa raste seancat e planifikuar. Përgjithësisht, shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale të tilla si: *kërkesa të ligjshme të palëve për shtyrjen e seancës, njoftimi i dëshmitarëve për t'u paraqitur e pyetur para gjykatës, mosdijenja e rregullt e palëve apo dëshmitarëve për shkak të adresave të pasakta, njoftimi i ekspertit, dhënia kohë ekspertit për t'u përgatitur në lidhje me detyrat e caktuara nga gjykata, dhënia*

kohë palëve ndërgjyqëse për t'u njohur me aktin e ekspertimit, dhënia kohë palëve për t'u përgatitur me shkrim për konkluzione përfundimtare etj.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, numri mesatar i seancave gjyqësore është më i vogël se 3, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtari në shmangien e seancave joproductive dhe administrimin e procesit gjyqësore përgjithësisht është e lartë, prandaj gjyqtari duhet të vlerësohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: *Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë, pasi numri mesatar i seancave gjyqësore rezulton të jetë 2.3 seanca dhe në çdo rast gjyqtari ka kryer veprimet e nevojshme procedurale për shmangien e seancave jo-produktive.*

2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : *“Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se ato kanë qenë të rregullta dhe të plota nga ana formale. Për veprimet e kryera në seancë përgatitore apo gjyqësore është mbajtur proces verbal gjyqësor, bazuar në dispozitat procedural civile (shih dosjet 1, 2, 3 e 4) dhe ato penale (shih dokumentin 3 e dosjen 5). Në çdo dosje civile të vëzhguar gjendet vendimi për caktimin e seancës përgatitore, aktet e njoftimit të palëve, kërkesat me shkrim të tyre dhe provat e paraqitura, me përjashtim të dosjes 3, në të cilën nuk gjendej i administruar vendimi për caktimin e seancës përgatitore.*

Të gjitha proces verbalet, të seancës përgatitore dhe ato gjyqësore të administruara në dosje rezultojnë se janë të plota, me të gjitha të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera. Gjithashtu, të gjitha proces verbalet rezultojnë të nënshkruara nga sekretaria gjyqësore dhe nga gjyqtari, konform kërkesave të nenit 118 të K.Pr.Civile dhe nenit 345 të K.Pr.Penale. Procesverbali gjyqësor në formatin letër dokumenton kohën dhe vendin, si dhe veprimet që kryehn në seancë. Në asnjë rast të çeljes së seancës gjyqësore, nuk është konstatuar vonesë në proces verbal, por konstatohet gjithashtu se nga 18 seancat gjyqësore të 5 dosjeve të vëzhguara, ka rezultuar se vetëm 3 prej tyre janë dokumentuar me regjistrim audio, në kundërshtim me funksionin e transparencës dhe të solemnitetit në gjykim. Çmojmë lidhur me këtë, se mund të ketë ndikuar edhe gjendja e infrastrukturës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me numrin e pamjaftueshëm të sallave të gjykimit.

Dosjet kanë rezultuar të administruara rregullisht dhe janë sistemuar në mënyrë kronologjike, në fillim aktet e palëve ndërgjyqëse e më pas aktet e gjykatës, me përjashtim të dosjes 4 që nuk ishte sistemuar në mënyrë kronologjike. Megjithatë të gjitha dosjet rezultojnë të inventarizuara rregullisht, duke u bërë lehtësisht të shfrytëzueshme për palët”.

- Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Nga 11 (njëmbëdhjetë) çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, 9 (nëntë) prej tyre i përkasin kategorive të çështjeve civile dhe familjare me palë kundërshtare, 1 (një) çështje i përket kategorisë civile pa palë kundërshtare dhe 1 (një) çështje i përket kategorisë së kërkesave penale të hetimit paraprak.

Rezulton se gjyqtari ka vënë në lëvizje të gjitha çështjet, duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore dhe vendim për caktimin e seancës gjyqësore menjëherë ose brenda afatit ligjor, pas caktimit të çështjes me short duke iu referuar rregullave dhe gjykimit të çështjeve civile. Seancat përgatitore dhe gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës të mbajtur nga sekretarja gjyqësore dhe vetëm në pak raste procesverbali është mbajtur edhe me sistemin e regjistrimit audio. Shkak i mos zhvillimit të të gjitha seancave gjyqësore me sistemin audio mund të kenë qenë për arsye administrative dhe funksionaliteti në gjykatën pranë se cilës ka ushtruar funksionin gjyqtari në periudhën e vlerësimit (për shkak të pamundësisë së zhvillimit të seancës gjyqësore në sallë), por një fakt i tillë nuk është relatuar në asnjë rast nga gjyqtari⁷³. Megjithatë për efekt të sigurimit të një procesi gjyqësor transparent dhe ruajtjes së solemnitetit seancat dhe çdo veprim duhet të dokumentohen me regjistrim audio ose audiovizive sipas nenit 118 të K.Pr.Civile, dhe mosregjistrimi i tyre duhet jetë vetëm për arsye të përligjura dhe të dokumentuara, pra në procesverbalin e mbajtur me dorëshkrim.

⁷³ Neni 118 i K.Pr.Civile në fuqi në atë kohë (përpara ndryshimeve të bërë me ligjin nr.38/2017) parashikonte se:” Kryetari i seancës duhet të sigurohet që të mbahet procesverbal nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv për seancën gjyqësore, si dhe për çdo veprim tjetër procedural gjyqësor që zhvillohet jashtë seance. Nëse nuk është e mundur që procesverbali të mbahet nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv, ai mbahet duke bërë një përmbledhje të saktë me shtypshkrim apo dorëshkrim.”

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtari i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore duke caktuar seancën dhe duke kryer njoftimet përkatëse për palët.

Në lidhje me njoftimin dhe caktimin e seancave përgatitore dhe gjyqësore është konstatuar se në rastin kur gjyqtari ka disponuar për njoftimin e palëve me shpallje publike, në caktimin e seancës së rradhës nuk ka mbajtur në konsideratë respektimin e afatit minimal 20 ditore që shpallja publike duhet të qëndrojë e afishuar pranë vendeve përkatëse sipas nenit 133 të K.Pr.Civile⁷⁴, duke e caktuar seancën e rradhës në një afat më pak se 20 ditë apo dhe e ka caktuar për 20 ditë, duke mos i lënë kohë që shpalljet publike të qëndrojnë të afishuar për së paku 20 ditë. Konkretisht konstatohet se ky afat nuk është respektuar në caktimin e seancave në çështjet që i përkasin vendimeve nr.5408, datë 02.05.2014, nr. 4919, datë 17.04.2014, nr. 3004, datë 12.04.2016 dhe nr.2092, datë 15.03.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku seancat e rradhës pasi gjykata ka urdhëruar që njoftimi të bëhej me shpallje janë caktuar për 13 ditë, për 15 ditë, për 17 ditë dhe në një rast për 20 ditë. Mosrespektimi i këtij afati ligjor e bën njoftimin për palën e paditur të pavlefshme sipas nenit 122 të K.Pr.Civile⁷⁵. Gjithashtu, është konstatuar se gjyqtari në asnjë rast nuk ka verifikuar nëse njoftimi është afishuar në adresë dhe datën kur njoftimi me shpallje është afishuar në mënyrë që të llogarisë nëse shpallja publike kishte qëndruar e afishuar për më shumë se 20 ditë. Të gjitha shpalljet mbajnë shënimin e ftuesit të gjykatës që ka marrë njoftimin me shpallje (megjithëse nuk është specifikuar data kur është marrë një njoftim i tillë) dhe nuk rezulton të jetë bërë shënimi përkatëse se njoftimi është afishuar në adresat përkatëse si dhe datën kur këto njoftime janë afishuar. Gjithashtu në dy raste seancat janë shtyrë për të kryer njoftimin me shpallje, krahas njoftimit me letërthirrje por ka rezultuar se shpalljet nuk janë afishuar, duke u bërë shkak për shtyrjen e seancave, referuar përmbajtjes së procesverbalit.

Në lidhje me zhvillimi i seancës së pajtimit konform nenit 134 të K.Familjes, ka rezultuar se në dy çështjet familje, me objekt zgjidhje martesë, nga ana e gjyqtarit nuk është zhvilluar seanca e pajtimit sipas përcaktimit të bërë në këtë nen⁷⁶ dhe gjithashtu nuk rezulton që gjyqtari të ketë bërë përpjekje për pajtim, referuar përmbajtjes së procesverbalit të seancës përgatitore/ pajtimit. Në një rast është konstatuar se gjyqtari në seancën e pajtimit të

⁷⁴ Neni 133 i K.Pr.Civile në fuqi në atë kohë parashikonte se; ” Kur personi i thirrur nuk i dihet vendbanimi ose vendqëndrimi në Republikën e Shqipërisë, ose nuk ka zgjedhur një banesë, apo nuk ka caktuar një përfaqësues të tij, sipas nenit 131 të këtij Kodi, njoftimi i aktit bëhet nëpërmjet afishimit të kopjes në gjykatën e vendit, ku do të gjykohet mosmarrëveshja, si dhe në vendin e afishimit, ku ka pasur vendbanimin e fundit. Ky njoftim qëndron i afishuar për jo më pak se 20 ditë.”

⁷⁵ Neni 122 i K.Pr.Civile në fuqi në atë kohë parashikonte se; ” Njoftimi është i pavlefshëm kur nuk janë zbatuar dispozitat që kanë lidhje me mënyrën dhe personin të cilit i duhet dorëzuar kopja e aktit ose kur ka pasiguri të plotë për personin ose datën e njoftimit.”

⁷⁶ Neni 134 i K.Familjes parashikon se; ” Në shqyrtimin e padisë për zgjidhjen e martesës, gjykata cakton fillimisht një seance pajtimi, në të cilën duhet të paraqiten personalisht bashkëshortët. Gjyqtari mund t'i dëgjojë ata veçmas secilin dhe me pas bashkërisht, pa praninë e përfaqësuesve të tyre. Kur arrihet pajtimi, mbahet procesverbal dhe gjykimi pushohet për këtë shkak.”

planifikuar si të tillë⁷⁷, pa prezencën e palës paditëse e cila ka qenë e përfaqësuar më një avokat dhe pasi ka verifikuar faktin se i padituri nuk është paraqitur dhe ka dëgjuar shpjegimet e përfaqësuesit të palës paditëse, në bazë të nenit 158/a të K.Pr.Civile ka vendosur të kaloj çështjen në seancë gjyqësore, duke mos zhvilluar kështu një seancë pajtimi.

Në lidhje me dokumentimin e veprimeve procedurale, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Drejtimi i procesit gjyqësor përgjithësisht ka qenë i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligji për gjykimin në shkallë të parë si në çështjet civile, ashtu edhe në çështjen penale.

Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjyqtari përgjithësisht ka treguar kujdes për verifikimin e paraqitjes së palëve dhe përfaqësuesve të tyre, relativitetin e akteve të njoftimit dhe marrjen ose jo dijeni nga palët që nuk janë paraqitur, disponimin me vendim të ndërmjetëm për zhvillimin e gjykimit në mungesë, në rastet e mosparaqitjes së palëve pa shkaqe të përligjura, shpalljen e trupit gjykues, dhënien e fjalës palëve për kërkesa paraprake, disponimin me vendim për kërkesat paraprake të palëve në rastet kur paraqiten kërkesa të tilla, deklarin e hapur të shqyrtimit gjyqësor, dhënien e fjalës palëve për paraqitjen e parashtrimeve dhe provave, administrimin e provave, drejtimin dhe orientimin e debatit mbi provat, si dhe mbi elementë proceduralë të zhvillimit të gjykimit, dhënien e fjalës palëve lidhur me vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor pas zhvillimit të debatit mbi provat, deklarin e mbyllur të shqyrtimit gjyqësor, dhënien e fjalës palëve për paraqitjen e diskutimit përfundimtar, tërheqjen e gjykatës për marrjen e vendimit dhe shpalljen e vendimit përfundimtar.

Lidhur me këtë tregues, në Metodologjinë e pikëzimit parashikohet se; *“Për të pikëzuar këtë tregues vlerësohet nëse gjyqtari kryen me efikasitet veprime si p.sh.:*

- *vënien në lëvizje e dosjes në kohë dhe në përputhje me afatet ligjore;*
- *kryerja e veprimeve përgatitore efektive dhe në kohë, duke marrë parasysh caktimin e afateve për të metat e padisë, njoftimin e akteve apo deklaratës së mbrojtjes;*
- *planifikimi dhe zhvillimi i seancave përgatitore efektive;*
- *dokumentimi i vendimeve dhe veprimeve të tjera procedurale;*
- *drejtimi i një procesi të rregullt gjyqësor, duke orientuar drejt debatit mes palëve, duke u shprehur qartë, me urdhra dhe vendime të ndërmjetme për çdo kërkesë të tyre;*
- *fillimi i seancave pa vonesë;*
- *regjistrimi audio i seancave;*
- *ndjekja me rigorozitet e fazave në të cilat kalon shqyrtimi gjyqësor;*
 - *orientimi i palëve për ndjekjen e rrugës alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, sikundër është ndërmjetësimi.”*

⁷⁷ Vendimi nr. 4919, datë 17.04.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka treguar shkallë aftësie mesatare në këtë tregues, evidentuar përgjithësisht në shpejtësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit të seancave përgatitore apo gjyqësore, duke respektuar përgjithësisht standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur përgjithësisht me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil. Por nuk konstatohet i njëjti kujdes nga gjyqtari në raport me korrektësinë në caktimin e seancave, që konsiston në llogaritjen e afatit në caktimin e seancës së rradhës me qëllim kryerjen e njoftimit sipas ligjit dhe për të siguruar njoftim efektiv të palëve ndërgjyqëse. Gjithashtu, gjyqtari nuk ka treguar kujdes në kryerjen veprimeve procedurale sipas parashikimit të Kodit të Familjes, që ka të bëjë me zhvillimin e seancës së pajtimit, planifikimi dhe zhvillimi i seancave përgatitore dhe gjyqësore efektive.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: *Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues është “mesatare”, duke e pikëzuar me 12 pikë.*

2.C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore

2.C.A. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : *“Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se ato kanë qenë të rregullta dhe të plota nga ana formale. Për veprimet e kryera në seancë përgatitore apo gjyqësore është mbajtur proces verbal gjyqësor, bazuar në dispozitat procedural civile (shih dosjet 1, 2, 3 e 4) dhe ato penale (shih dokumentin 3 e dosjen 5). Në çdo dosje civile të vëzhguar gjendet vendimi për caktimin e seancës përgatitore, aktet e njoftimit të palëve, kërkesat me shkrim të tyre dhe provat e paraqitura, me përjashtim të dosjes 3, në të cilën nuk gjendej i administruar vendimi për caktimin e seancës përgatitore.*

Të gjitha process verbalet, të seancës përgatitore dhe ato gjyqësore të administruara në dosje rezulton se janë të plota, me të gjitha të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedural të kryera. Gjithashtu, të gjitha process verbalet rezultojnë të nënshkruara nga sekretaria

gjqësore dhe nga gjyqtari, conform kërkesave të nenit 118 të K.Pr.Civile dhe nenit 345 të K.Pr.Penale. Proces verbali gjyqësor në formatin letër dokumenton kohën dhe vendin, si dhe veprimet që kryehn në seancë. Në asnjë rast të çeljes së seancës gjyqësore, nuk është konstatuar vonesë në proces verbal, por konstatohet gjithashtu se nga 18 seancat gjyqësore të 5 dosjeve të vëzhguara, ka rezultuar se vetëm 3 prej tyre janë dokumentuar me regjistrim audio, në kundërshtim me funksionin e transparencës dhe të solemnitetit në gjykim. Çmojmë lidhur me këtë, se mund të ketë ndikuar edhe gjendja e infrastrukturës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me numrin e pamjaftueshëm të sallave të gjykimit.

Dosjet kanë rezultuar të administruara rregullisht dhe janë sistemuar në mënyrë kronologjike, në fillim aktet e palëve ndërgjyqëse e më pas aktet e gjykatës, me përjashtim të dosjes 4 që nuk ishte sistemuar në mënyrë kronologjike. Megjithatë të gjitha dosjet rezultojnë të inventarizuara rregullisht, duke u brë lehtësisht të shfrytëzueshme për palët”.

Nga vëzhgimi i dosjeve, të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se dosjet janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik, sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e dosjeve ndjek kryesisht të njëjtën linjë, në dosjet e vëzhguara, duke grupuar aktet sipas kategorisë së tyre.

Renditja e dosjes, fillon me padinë dhe provat e paraqitura nga palët, vendimin e gjyqtarit për caktimin e seancës përgatitore, aktet e njoftimit të palëve, procesverbalet e seancave përgatitore, kërkesat dhe parashtrimet me shkrim të palëve gjatë gjykimit, procesverbalet e seancave gjyqësore dhe mbyllet me vendimin gjyqësor përfundimtar.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave. Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 5 pikë.*

2.C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : *“Dosjet kanë rezultuar të administruara rregullisht dhe janë sistemuar në mënyrë kronologjike, në fillim aktet e palëve ndërgjyqëse e më pas aktet e gjykatës, me përjashtim të dosjes 4 që nuk ishte sistemuar në mënyrë kronologjike. Megjithatë të gjitha dosjet rezultojnë të inventarizuara rregullisht, duke u brë lehtësisht të shfrytëzueshme për palët”*.

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, për saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes, rezulton se në dosje ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (*njoftimet për çdo seancë, procesverbalet e çdo seance gjyqësore, vendimet gjyqësore*), si dhe aktet e paraqitura nga palët (*kërkesat për saktësim objekti, kërkesat për shtyrje seance, konkluzionet përfundimtare të palëve kur janë paraqitur me shkrim*).

Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara, apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

KONKLUZIONI

DUKE IU REFERUAR BURIMEVE TË VLERËSIMIT, REZULTON SE GJYQTARI KA SHKALLË AFTËSIE SHUMË TË LARTË NË KËTË TREGUES.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive organizative të gjyqtarit”

Niveli i vlerësimit

KRITERI	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
92	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paañesi në funksion. Pikëzimi për treguesit e këtij kriteri bëhet në rend zbritës, dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar këtij kriteri vlerësimi, duke zbritur sipas rastit pikët në varësi të problematikave të shfaqura në lidhje me çdo tregues sipas burimeve të vlerësimit.

3.A. ETIKA NË PUNË

Lidhur me këtë nën kriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se : *“Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se gjyqtari Adriatik Bocaj ka marrë titullin “jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 31.03.1994. Me vendimin nr. 5, datë 01.07.1994 të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Më pas, me nr. 419, datë 20.12.2013 të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë është transferuar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku dhe aktualisht vazhdon të ushtrojë detyrën.*

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 - 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Adriatik Bocaj janë paraqitur në Inspektoratin e ish KLD-së, gjithsej 7 ankesa, ku 2 prej tyre janë arkivuar pas shqyrtimit paraprak me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor në gjykatat më të larta, ndërsa 5 ankesa janë verifikuar dhe ka rezultuar : 1 ankesë e verifikuar për shkelje procedural penale është vendosur tërheqja e vëmendjes me shkrim për gjyqtarin; 1 ankesë e verifikuar për shkelje etike është arkivuar, pasi nuk rezultuan shkelje dhe 3 ankesa të sugjeruara nga inspektorati për verifikim i janë dërguar për kompetencë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, nuk rezulton që ndaj tij të ketë ardhur ndonjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë propozuar në ish Këshillin e Lartë të Drejtësisë ndonjë masë për procedim disiplinor. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit Adriatik Bocaj”.

3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të Këshillit/ish KLD-së;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të ish KLD-së dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtarin Adriatik Bocaj, në periudhën e vlerësimit nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Ndërkohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar përmbajtjes së vendimit nr. 697, datë 15.09.2023 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nuk rezulton te jetë evidentuar apo shqyrtuar, në lidhje me elementë që mund të ndikojnë në vlerësimin lidhur me etikën e gjyqtarit.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e etikës së gjyqtarit në treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 35 pikë.

3.B. INTEGRITETI I GJYQTARIT

Lidhur me këtë nënkriter, në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se : “Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Adriatik Bocaj dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij, ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm”.

3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të Këshillit/ish KLD-së;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI-së pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të ish KLD-së dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtarin Adriatik Bocaj, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Nga përmbajtja e vendimit nr. 697, datë 15.09.2023 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lidhur me vlerësimin e kriterit pasuror, pas vlerësimit të raportit të ILDKPKI-së dhe hetimit administrativ të kryer, rezulton se : “...**Konkluzion mbi vlerësimin e pasurisë**

27.9 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht. Nga hetimi administrativ i kryer dhe shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se subjekti i rivlerësimit në deklaratën Vetting ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, sipas arsytimit dhe përfundimeve trajtuar në pikat 21.12 dhe 21.13 të këtij vendimi, trupi gjykues çmon se ato nuk janë të mjaftueshme që të sjellin aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të tyre, ato nuk cenojnë figurën e gjyqtarit dhe as besimin e publikut te drejtësia. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Adriatik Bocaj, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016”⁷⁸.

Në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të mësipërm të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në të njëjtën kohë, janë shqyrtuar dhe vlerësuar elementë në lidhje me integritetin e gjyqtarit, të cilët pasi janë analizuar në kuadër të vlerësimit figurës, duke konkluduar se: “**28.3** Nga hetimi administrativ i kryer nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

⁷⁸ Faqe 20 e vendimit nr. 697, datë 15.09.2013 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

28.4. *Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Adriatik Bocaj, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016*⁷⁹.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të integritetit, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme, apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e tij.

***Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi:** Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtarit në treguesin “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.*

3.C PAANËSIA E GJYQTARIT

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se : *“Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Adriatik Bocaj. Në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara, nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera, që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, nuk ka respektuar rregullat procedural me pasojë cenimin e parimit të gjykatës së paanshme”*.

3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me shot dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);

⁷⁹ Po aty, faqe 21.

- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit, duke përfshirë dhe regjistrimet audio të seancave (6 dosjet e përzgjedhur me short).

Referuar përmbajtjes së vendimeve gjyqësore, burim vlerësimi, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari apo në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese nga ana e gjyqtarit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, aftësia e gjyqtarit në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat statistikore.

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : “Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Adriatik Bocaj. Në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara, nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve..”.

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtarit, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore.

Nga burimet e tjera (burimet arkivore të Këshillit/ish KLD-së), si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranura të palëve për përjashtimin e gjyqtarit në periudhën e vlerësimit.

Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit. Në këto kushte, referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar për shkak të statusit të tij është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranura të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, në kushtet kur në rastet e gradimit zbatohen për aq sa është e mundur dispozitat e Ligjit për Statusin, vlerësohet se numri i kërkesave të pranura të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është i pakonsiderueshëm.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë, të kërkesave të pranura të palëve për përjashtimin e gjyqtares. Prandaj, për këtë tregues numri i kërkesave të pranura të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, duhet të vlerësohet si i pakonsiderueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, në treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranura të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” vlerësohet “I pakonsiderueshëm” dhe pikëzohet me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSIA PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se : *“Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në proces verbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtari Adriatik Bocaj, komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Gjuha e përdorur në aktet e dosjeve të vëzhguara është normale komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe e qartë, nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo element që lidhen me paanësinë e tij. Në të gjitha rastet e vëzhguara, nuk është konstatuar që ndonjë prej palëve të ketë paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit dhe as kërkesë të vetë gjyqtarit për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes”.*

4.A.A KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjor të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhur me short*).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (*kryesisht procesverbaleve të seancave, regjistrimet e seancave në sistemin audio, komunikimet shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore*) rezulton se gjyqtari gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është i qartë, transparent, i kuptueshëm. Gjithashtu, evidentohet komunikim i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore rezultojnë të njëjta cilësi edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe e drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë dhe koncize, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 25 pikë.

4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhur me short).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore, të përzgjedhura nga vetë gjyqtari për vlerësim dhe akteve të dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit, apo të të dhënave personale të subjekteve të procedimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” vlerësohet “E lartë”, dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR

Lidhur me këtë nënkriter, në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se : “Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e

vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit Adriatik Bocaj, për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Në 8 rastet, subjekti i rivlerësimit ka qenë gjyqtar i vetëm për gjykimin e çështjes dhe ka bashkëpunuar me administratën gjyqësore për të zhvilluar seancën sipas rregullave procedural civile e penale”.

4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, shërbejnë edhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për mungesë të bashkëpunimit me kolegët, për rrjedhojë, prezumohet se ky komunikim është në nivel të lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, prezumohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” vlerësohet “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burim vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është dhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin) dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për rrjedhojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për shkallën e komunikimit me administratën gjyqësore dhe mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se komunikimi dhe bashkëpunimi me administratën gjyqësore është shumë i lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkallë të ulët të komunikimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për rrjedhojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, prezumohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, aftësia e gjyqtarit në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARIT PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se : “ *Subjekti i rivlerësimit Adriatik Bocaj, për shkak të funksionit të gjyqtarit të shkallës së parë i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ai ka marrë pjesë 13 trajnime të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, gjithsej 25 ditë të formimit vazhdues Lënda e trajnimeve, ku ai ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë, në përbërje të dhomave civile e penale. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës ka marrë pjesë në kursin “Njohuri fillestare për kompjuterin” duke bashkëlidhur certifikatën e dhënë nga Instituti “Harry Fultz”*”.

4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARIT NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHDUES TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit.

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale dhe formularit të vetëvlerësimit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se gjyqtari Adriatik Bocaj ka marrë pjesë. Referuar vërtetimit me 681 prot., datë 21.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës dhe formularit të vetë deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues në 13 aktivitete trajnuese të zhvilluara në 25 ditë, kryesisht në fushën e së drejtës civile.

Lidhur me pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese, ligji nr. 9877, datë 18.02.2018 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në fuqi në periudhën e vlerësimit, nuk përmbante një parashikim lidhur me detyrueshmërinë e pjesëmarrjes së gjyqtarit në aktivitete trajnuese. Ndërkohë, ky detyrim parashikohej në nenin

23 të ligjit nr. 8316/1999 “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar, sipas të cilit gjyqtarët dhe prokurorët e gjykatave e të prokurorive të shkallës së parë dhe të gjykatave të apeleve i nënshtrohen formimit vazhdues. Periudha e formimit vazhdues nuk duhet të kalojë më shumë se 20 ditë në vit dhe jo më shumë se 60 ditë gjatë pesë vjetëve.

Aktualisht, në Ligjin për Statusin, pjesëmarrja në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës është përcaktuar si e drejtë dhe njëkohësisht detyrim i gjyqtarit, duke përcaktuar edhe kufirin minimal dhe maksimal të pjesëmarrjes gjatë një viti, si dhe gjatë pesë viteve.⁸⁰ Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues përcaktohet se gjyqtarët kanë detyrimin ligjor të ndjekin programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Gjyqtari duhet t'i kushtojë kohë evoluimit të mendimit juridik dhe jurisprudencës dhe të ndjekë programe trajnimi që nxitin specializimin e tij, të organizuara edhe nga institucione të tjera trajnimi, në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të njohura nga Këshilli.

Në lidhje me pikëzimin e aftësisë së gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera, treguesi i pjesëmarrjes në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, matet duke u bazuar në informacionin me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e magjistratit në trajnime. Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime të tjera vlerësohet bazuar në dokumente të dorëzuara prej tij, që tregojnë ngritjen profesionale. Sa më sipër, pavarësisht se Ligji për Statusin dhe Metodologjia e Pikëzimit e miratuar me vendimin e Këshillit nr. 264, datë 21.11.2019, nuk kanë qenë në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar nenit 23, të ligjit nr. 8316/1999 “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar, sipas formulimit të tij në periudhën e vlerësimit, rezulton se pjesëmarrja e gjyqtarit në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës ka qenë e rregulluar nga ky ligj, duke përcaktuar vetëm kufirin maksimal të angazhimit për 1 dhe 5 vjet dhe jo një detyrim minimal pjesëmarrjeje.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, referuar të dhënave lidhur me angazhimin e gjyqtarit në aktivitete trajnuese brenda ose jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, gjatë periudhës së vlerësimit 2013-2016, pikëzimi për këtë tregues, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, do të jetë me 20 pikë, pasi legjislacioni i kohës parashikonte vetëm kufirin maksimal të pjesëmarrjes në aktivitete trajnuese, por jo një kufi minimal

⁸⁰ Në nenin 5 të Ligjit për Statusin, parashikohet se : “1. Magjistrati ka të drejtë dhe detyrimin të marrë pjesë në programet e formimit vazhdues. Magjistrati ka të drejtë të propozojë tema trajnimi dhe të bashkëpunojë me Këshillin, me qëllim përmirësimin e programeve të trajnimit. 2. Magjistrati duhet: a) të ndjekë formimin vazhdues, në përputhje me legjislacionin në fuqi; b) të marrë çdo masë tjetër të arsyeshme për t'u përditësuar me ndryshimet legjislative dhe të jurisprudencës. 3. Periudha e formimit vazhdues duhet të jetë: a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve; b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve. 4. Magjistrati duhet të përmbushë detyrimin për të marrë pjesë në formimin vazhdues vetëm në ato raste kur programet e trajnimit janë: a) të përshtatshme për funksionin e tij; b) të organizuara dhe certifikuara nga Shkolla e Magjistraturës ose nga çdo institucion trajnimi në nivel kombëtar ose ndërkombëtar të njohur nga Këshilli. Një kopje e certifikatës vendoset në dosjen personale të magjistratit.”

pjesëmarrjeje në aktivitete trajnuese, sikurse përcaktohet aktualisht në nenin 5, të Ligjit për Statusin.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës dhe jashtë saj, kryesisht të për tema që i përkasin së drejtës civile, gjithsej 13 aktivitete të zhvilluara për 25 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën tre vjeçare, megjithëse sipas ligjit të kohës nuk kishite një parashikim të tillë.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, vlerësohet se pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitetet trajnuese të Sh. M dhe trajnime të tjera profesionale është brenda kufijve 15-120 ditë, dhe për këtë arsye pikëzohet me 20 pikë.

4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARIT PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtarit në veprimtari trajnuese.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtarit, për periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jetë referuar për angazhimin e tij në veprimtari trajnuese si ekspert ose lehtësues në programin e Shkollës së Magjistraturës, apo të ndonjë institucioni tjetër. Gjithashtu, nuk rezultojnë të dhëna lidhur me gatishmërinë e tij për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësohet se për gjyqtarin Adriatik Bocaj ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si ekspert/lehtësues dhe as angazhimi i tij për udhëheqjen e kandidatëve për gjyqtarë gjatë viti të stazhit profesional.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, në treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”, gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.

4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARIT NË VEPRIMTARI NDËR-INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtarit, si dhe akteve të paraqitura lidhur me këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtari për periudhën e vlerësimit 2013-2016 të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësohet se për gjyqtarin Adriatik Bocaj ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.

4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtarit, nuk rezulton që gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit të ketë realizuar publikime ligjore akademike, me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit vlerësohet se për gjyqtarin Adriatik Bocaj ky tregues duhet të pikëzohet me 0 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtari të ketë realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, nuk mund të vlerësohet për këtë tregues.

Angazhimi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, në treguesin “Publikime ligjore akademike” gjyqtari duhet të vlerësohet dhe pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
91	Shkëlqyeshëm

**PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI
DHE
NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT**

Referuar nenit 78 të Ligjit për Statusin dhe Vendimit Nr.264 dt.21.11.2019 të KLGJ “Metodologjia e Pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, niveli i përgjithshëm i vlerësimit përcaktohet si më poshtë :

Vlerësimi i gjyqtarit kryhet sipas këtyre niveleve:

- a) *Vlerësimi i përgjithshëm “shkëlqyeshëm” jepet në ato raste kur magjistrati është vlerësuar “shkëlqyeshëm” për të katërta kriteret.*
- b) *Vlerësimi i përgjithshëm “shumë mirë” jepet vetëm në ato raste kur magjistrati vlerësohet “shumë mirë” për tre kriteret dhe “mirë” për njërin prej tyre. Në çdo rast, kriteret “aftësitë profesionale të gjyqtarit” dhe “etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit” duhet të jenë vlerësuar “shumë mirë”.*
- c) *Vlerësimi i përgjithshëm “mirë” jepet në rastin kur aftësitë e magjistratit vlerësohen “mirë” për dy kriteret dhe “mjaftueshëm” për dy kriteret e tjera. I njëjti rregull zbatohet edhe në rastin kur ka barazi në vlerësimin e kriterëve në nivelet “mjaftueshëm” dhe “i pamjaftueshëm”. Në çdo rast, kriteret “aftësitë gjyqësore” dhe “etika dhe përkushtimi ndaj vlerave të gjyqësorit” duhet të vlerësohen të paktën “mirë”.*
- d) *Vlerësimi i përgjithshëm “i pamjaftueshëm” jepet në këto raste:*
 - i. *kur magjistrati vlerësohet “i pamjaftueshëm” për të paktën në 3 kriteret;*
 - ii. *kur magjistrati vlerësohet “i pamjaftueshëm” për kriteret “aftësitë profesionale të gjyqtarit” dhe “etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit” dhe jo më shumë se “mirë” për dy kriteret e tjera.*

Për çdo kombinim tjetër të ndryshëm nga ato të parashikuar më lart, niveli i përgjithshëm i vlerësimit do të përcaktohet në varësi të mesatares së pikëve të katër kriterëve, sipas shkallës së pikëzimit të përcaktuar në pikën 9 të kësaj metodologjie. Në çdo rast niveli i përgjithshëm i vlerësimit, nuk mund të jetë më i lartë, se niveli i vlerësimit për kriteret “aftësitë profesionale të gjyqtarit” dhe “etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit”.

Lidhur me përcaktimin e nivelit të vlerësimit, në Metodologjinë e Pikëzimit, miratuar me vendimin Nr.264 dt.21.11.2019 të KLGJ është përcaktuar qartë, si niveli i vlerësimit përcaktohet në bazë të niveleve të vlerësimit për secilin kriteri vlerësimi sipas kombinimeve përkatës. Në rast se nuk ndodhemi përpara këtyre kombinimeve, niveli i vlerësimit bëhet si metasare e pikëve të katër kriterëve, ku në çdo rast niveli i përgjithshëm i vlerësimit nuk mund të jetë më i lartë se ai i “Aftësive profesionale” dhe kriterit “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit”. Në rast se një nga këto dy kriteret ka një nivel të caktuar vlerësimi, më të ulët se kriteret e tjera, vlerësimi i përgjithshëm nuk mund të jetë më i lartë se ky nivel i

vlerësimit. Pra niveli i përgjithshëm i vlerësimit duhet të përputhet me nivelin e vlerësimit më të ulët të përcaktuar për secilin nga këto kriteri. Në rastin konkret, niveli i vlerësimit për kriterin “aftësitë profesionale të gjyqtarit” është në nivelin “Mirë” dhe për këtë arsye niveli i përgjithshëm i vlerësimit është përcaktuar në “Mirë”.

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	55	Mirë
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	92	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	91	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	338	Mirë

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

SHTOJCA 1

KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTARIN ADRIATIK BOCAJ

PERIUDHA E VLERËSIMIT 2013-2016

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES			Pikët total	Niveli i vlerësimit	
			55	Mirë	
Treguesit	Burimet	Shkalla e aftësisë	Pikët	Të dhëna për metodologjinë	
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 	Mesatare	15	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 	Mesatare	15	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit 	Mesatare	9	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë

		(6 dosjet e përzgjedhura me short)			Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 	Mesatare	6	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 	Nën mesataren	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				92	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 	0-10%	15	Jashtë afatit: Mbi 40% - 3 pikë 31-40% - 6 pikë 21-30% - 9 pikë 11-20% - 12 pikë 0-10% - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të 	0-10%	5	Jashtë afatit: Mbi 40% - 1 pikë 31-40% - 2 pikë

		procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short)			21-30% - 3 pikë 11-20% - 4 pikë 0-10% - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	5	<p>Koha mesatare:</p> <p>Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë</p> <p>Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë</p> <p>Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë</p> <p>Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë</p> <p>Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë</p>
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit 	+99%	10	<p>Tej standardit :</p> <p>Nën 81%- 2 pikë</p> <p>Mbi 81-87% - 4 pikë</p> <p>Mbi 87- 93% - 6 pikë</p> <p>Mbi 93-99% - 8 pikë</p> <p>+99% - 10 pikë</p>
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të 	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për	15	<p>Koha mesatare:</p> <p>Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë</p>

		<p>procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Informacioni i përcjellë nga gjykata lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar 	të gjitha kategoritë e çështjeve		<p>Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë</p> <p>Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë</p> <p>Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë</p> <p>Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë</p>
B. Aftësia e gjyqtares për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë	15	Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtares: Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 	Mesatare	12	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë

C. Aftësia e gjyqtares për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 	Shumë e lartë	5	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë	
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë	
3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE					Pikët total	Niveli i vlerësimit
					100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia	
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit 	Shumë e lartë	35	Shkalla e etikës në punë e gjyqtares: E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë	
B. Integriteti i gjyqtares	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit 	Shumë e lartë	40	Shkalla e integritetit të gjyqtares : E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë	

C. Paanësia e gjyqtares	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 	Shumë e lartë	10	Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtares	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit 	I pa konsiderueshëm	15	Numri i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtares: Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				91	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 	Shumë e lartë	25	Qartësia dhe transparenca e komunikimit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short 	I lartë	15	Respektimi i konfidencialitetit:

		pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short)			I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	▪ Dosja e rivlerësimit	Shumë e lartë	15	Shkalla e komunikimit: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	▪ Dosja e rivlerësimit	Shumë e lartë	10	Shkalla e komunikimit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
C. Gatishmëria e gjyqtarës për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtarës në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	▪ Dosja e rivlerësimit	15-120 ditë	20	Pjesëmarrja e gjyqtarës: (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4
	b. Disponueshmëria e gjyqtarës për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	▪ Dosja e rivlerësimit	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Angazhimi i gjyqtarës në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	▪ Dosja e rivlerësimit	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë

	ç. Publikimet ligjore akademike	▪ Dosja e rivlerësimit	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT			338		
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARES			Mirë		

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR